



Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave

Komuna e Deçanit

2018 - 2022

Maj 2018

Fjala e Kryetarit

Qytetarë të komunës së Deçanit, ne si administratë komunale jemi zotuar që të menaxhojmë mbeturinat në mënyrë sa më të qendrueshme. Hartimi i Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave e konfirmon zotimin tonë në këtë fushë. Nëpërmes këtij plani komuna e Deçanit do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të investuar në mënyrë të planifikuar në sistemin e menaxhimit në komunë. Planifikimi i tillë do të përmirësojë gjendjen e menaxhimit të mbeturinave, dhe përfundimisht do të ndikojë edhe në gjendjen mjedisore në komunën tonë. Duke e rregulluar sistemin e menaxhimit të mbeturinave në komunë ne gjithashtu synojmë që të krijojmë kushte edhe për zhvillim ekonomik lokal, nëpërmes veprimeve për ndarje dhe reciklim.

Në fund, ne si administratë komunale jemi duke bërë përpjektet për të krijuar një ambient sa më të pastër për qytetarët tanë, mirëpo kjo mund të arrihet vetëm në bashkepunim të plotë të të gjithë akterëve në komunë.

Singerisht,
Bashkim Ramosaj

Tabela e përmbajtjes

1. Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave.....	6
1.1. Qëllimi i planit	6
1.2. Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë	6
1.3. Korniza ligjore.....	7
1.4. Rolet dhe përgjegjësitë në nivel qendror dhe lokal.....	7
2. Konteksti lokal	9
2.1. Përshkrim i situatës në Komunë	9
2.2. Të dhëna mbi venbanimet në Komunë dhe popullësinë	10
2.3. Të dhëna mbi sektorët tjerë.....	11
3. Menaxhimi i mbeturinave.....	13
3.1. Detyrat dhe përgjegjësitë në menaxhimin e mbeturinave.....	13
3.2. Shkalla e mbulueshmërisë së territorit me shërbime.....	14
3.3. Sistemi ekzistues i menaxhimit të mbeturinave.....	20
3.4. Sasia dhe lloji i mbeturinave	21
3.5. Deponimi i mbeturinave	24
3.6. Ndarja, Trajtimi dhe riciklimi	25
3.7. Rrjedhat tjera të mbeturinave	26
3.8. Deponitë ilegale - mbeturinat ndërtimore.....	26
.....	28
4. Performanca e ofruesit të shërbimeve	29
4.1. Performanca Operative	29
4.2. Performanca Financiare – Kostot e Shërbimit.....	30
4.3. Kosto totale e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.....	33
4.4. Performanca Financiare – Të hyrat dhe mbulimi i koston.....	35
4.5. SWOT analiza.....	37
4.6. Sfidat e menaxhimit të mbeturinave.....	38
5. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE.....	40
5.1. Vizioni.....	40
5.2. Objektivat e nivelit qendror	40
5.3. Objektivat e PKMM Deçan.....	41
6. Plani financiar.....	55
6.3. Projektioni i kostove të shërbimit.....	55
6.4. Projektionet e të hyrave dhe arkëtimit	64
6.5. Mbulimi i koston dhe financimi i programit të MM	65
7. Plani i veprimit	69

Lista e shkurtesave

BE	Bashkimi Evropian
DMSHShP	Departamenti për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbimeve Publike
GIZ	Die Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
NPK	Kompania Komunale për Grumbullimin e Mbeturinave
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
KRM	Kompania Regjionale për Grumbullim të Mbeturinave
MM	Menaxhim i Mbeturinave
NP	Ndërmarrje Publike
NPK	Ndërmarrje Publike Komunale
PKMM	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave
PRKMM	Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
QK	Qeveria e Kosovës
QKMF	Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra të Mjekësisë Familjare
SMS	SustainableMunicipalServices
SRKMM	Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave

1. Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

1.1. Qëllimi i planit

PKMM-ja paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Komuna e Deçanit është e përcaktuar që të përmirësoj gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe në këtë drejtim ka parashtruar qëllimin dhe objektivat specifike që janë pjesë integrale e këtij plani.

Qëllimi i PKMM është ofrimi i kornizës strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për periudhën pesëvjeqare për territorin a administruar nga komuna në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike. PKMM është i hartuar në mënyrën që merr për bazë parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave si në vijim:

- Parimi i menaxhimit të mbeturinave sipas prioritetit, d.m.th. dhënja prioritet aktiviteve të reduktimit, minimizimit dhe procesimit të mbeturinave karshi deponimit të tyre.
- Përgjegjësia e prodhuesit, d.m.th. Prodhuesit e mbeturinave janë të detyruar të bartin koston e të gjitha masave parandaluese për ndotjen e mjedisit, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave.
- Parimi ndotësi paguan, d.m.th. palët që ndotin mjedisin duhet të bartin koston e plotë të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë kostot e masave parandaluese dhe eliminimin e dëmit të shkaktuar nga aktivitet e tyre.
- E drejta e qasjes në informacione, d.m.th. qytetarët duhen të jenë të informuar dhe të kenë qasje tek informacioni relevant.
- Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje, përfshi hartimin dhe miratimin e PKMM.
- Qasja hap pas hapi dmth përmirësimi gradual i gjendjes së menaxhimit të mbeturinave përmes marrjes së veprimeve në etapa.

PKMM do të shërbej si kornizë planifikuese dhe e veprimit për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e buxheteve, përpilimin e planeve investuese, si dhe tërheqjen e asistencës së jashtme.

1.2. Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë

Gjendja e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë aktualisht është mjaft e palakmueshme dhe kjo konstatohet në dokumente të ndryshme zyrtare dhe jozyrtare si psh Raporti i Gjendjes së Mjedisit dhe Raporti i Gjendjes së Mbeturinave. Një pjesë e konsiderueshme e popullatës nuk është e mbuluar me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, si dhe mbeturinat e gjeneruara nga kjo pjesë e popullatës përfundojnë në deponi ilegale, në brigje të lumenjëve dhe vende tjera të papërshtatshme. Edhe për pjesën e tjetër të popullatës të mbuluar me shërbim gjendja e menaxhimit të mbeturinave nuk është e kënaqshme.

Probleme ka me cilësinë e shërbimeve, infrastrukturën e vjetëruar të kontejnerëve dhe kamionëve dhe me menaxhimin e deponive në nivel regional dhe komunal të cilat janë shëndrruarnë burim të ndotjes për mjedisin.

Problemet janë të shumta edhe me menaxhimin e llojeve tjera të mbeturinave. Në mungesë të infrastrukturës adekuate mbeturina e mbetjeve shtazore përfundojnë në deponitë sanitare apo në vende tjera joadekuate. Përkundër përpjekjeve të Qeverisë dhe Bashkimit Evropian ende nuk është ndërtuar impianti për procesimin e mbetjeve shtazore në nivelin qendrorë. Aktivitetet e shtuara ndërtimore shpeshherë të pakontrolluara kanë rezultuar në gjenerim të sasive të mëdha të mbeturinave e cila në mungesë të deponive inerte është ndër shkaktarët kryesor për krijimin e deponive ilegale.

Komplekset industrial të kohës së paraluftës si Shkëmborja Trepça, Kosova A, Industria e Tekstilit Emin Duraku Gjakovë, IMK Ferizaj, dhe të ngajshme në mungesë të impianteve trajtuese dhe teknologjive joadekuate të cilat nuk kanë shfrytëzuar si duhet lëndën e parë

kanë rezultuar në gjenerim të madh të pikave kritike (hotspoteve)¹ me mbeturinave të rrezikshme të cilat paraqesin rrezik potencial për ambientin. Për sanimin e tyre nevojiten studime të specializuara si dhe mjete financiare dhe pajisje teknologjike të kushtueshme të cilat për momentin nuk janë në dispozicion.

Donacionet dhe tregtimi i pakontrolluar i barnave dhe materialeve medicinale ka sjell deri te gjenerimi i sasive të konsiderueshme të barnave, dhe llojeve tjera të materialeve shpenzuese të cilave ju ka kaluar afati dhe janë shndërruar në mbeturina të rrezikshme. Kësaj sasive i shtohet edhe material medicinal për asgjësim dhe barna me afat te skaduar nga QKMF dhe të gjitha spitaleve rajonale. Asgjësimi i këtij materiali të rrezikshëm është i kushtueshëm dhe kërkon angazhimin e operatorëve të specializuar.

Mungesa e sistemit funksional për menaxhimin e mbeturinave, ka pasur dhe vazhdon të ketë efekte negative në mjedis, ujë, ajër, tokë dhe shëndetin e njeriut. Kjo imponon që në periudhën aktuale faktorët relevant të organizohen dhe ti japin mbështetjen e duhur menaxhimit të përmirësuar të mbeturinave në nivel të Kosovës.

1.3. Korniza ligjore

Akti themelor për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është Ligji 2011-04 L 060 për Mbeturinat i cili rregullon aspektet specifike të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe llojeve tjera të mbeturinave. Ligji në fjalë ndërmjet tjerash ofron parimet bazë mbi menaxhimin e mbeturinave përfshi klasifikimin e mbeturinave si dhe rolet e përgjegjësive të aktorëve kyq në menaxhimin e tyre, si aspektet e operimit, dhe licencimit të operatorëve.

Në mënyrë specifike Ligji i Mbeturinave përmes Nenit 15 i përcakton kompetencat e komunave sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Komunat sipas këtij Neni janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planeve Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave (PKMM), krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përzgjedhjes së operatorëve të licencuar si dhe përcaktimit të tarifave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve. Ligji i mbeturinave është hartuar në masë të konsiderueshme në linjëme direktivat përkatës të KE që e rregullojnë lëminë e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe rrjedhave tjera të mbeturinave.

Korniza Ligjore përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Këto Ligjë përfshijnë: Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.

Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të komunave përfshi edhe aspektet e menaxhimit operativ dhe financiar të shërbimit dhe buxhetimit.

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ndërmjet tjerash rregullon aspektet relevante të pronësisë së ndërmarrjeve publike NP për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen kooperative, transparencën financiare, dhe formimin e ndërmarrjeve komunale.

Dokumentat tjera planifikuese-ligjore në lëmin e menaxhimit të mbeturinave janë edhe: Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2024, Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2017, dhe Master Plani i Menaxhimit të Mbeturinave 2015-2024.

1.4. Rolet dhe përgjegjësitë në nivel qendror dhe lokal

Rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq sa i përket menaxhimit të mbeturinave janë të sanksionuara me Ligjin mbi Mbeturina dhe aktet tjera relevante ligjore dhe nënligjore. Autoritet kryesore të menaxhimit të mbeturinave janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor dhe Komunat e Kosovës.

¹Të ashtu quajturahotspote

Sipas Ligjit të Mbeturinave Ministria administron me mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat toksike, mbeturinat likuide, industriale dhe të ngjashme. Komunitet nga ana tjetër menaxhojnë me mbeturinat komunale, mbeturinat inerte (dhe nga demolimet), mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat tjera jo të rrezikshme.

Neni 14 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e MMPH dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i). Hartimin e ligjeve, politikave dhe strategjisë për menaxhimin e mbeturinave; (ii) zbatimin e strategjisë dhe masterplanit; (iii) dhënjen e licencave për operatorët; (iv) dhe krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për menaxhimin e mbeturinave (MM).

Neni 15 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e Komunave dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i) krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave; (ii) hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave; (iii) përzgjedhjen e personave të licencuar për menaxhimin e mbeturinave; dhe (iv) caktimin e tarifave të mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve.

Autoritet tjera për menaxhimin e mbeturinave janë:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike në Nivel Qëndror përfshi Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës; caktimi i tarifave për deponimin e mbeturinave
- Ministria e Shëndetësisë: Menaxhimin e Mbeturinave dhe Produkteve Medicinale
- Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural: - menaxhimi i mbeturinave veterinare.
- Ministria e Punëve të Brendshme: - bënë koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e dëmeve eventuale nga mbeturinat
- Dogana e Republikës së Kosovës, kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave
- Policia e Republikës së Kosovës bashkëpunon me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe keqpërdorimit të mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në MM janë paraqitur si më poshtë:

- Komuna kontraktin operatorët (publik apo privat) për aktivitetet e Menaxhimit të Mbeturinave, në bazë të ligjit.
- Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbimeve Publike (DMSHShP) është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera komunale.
- DMSHSHP është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave
- Drejtoria e Financave është përgjegjëse për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- Drejtoria për Urbanizëm, e cila ndër të tjera është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik të Komunës, ndihmon në përgatitjen e rregullores lokale për kontroll të mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të Komunës.
- Drejtoria për Punë Inspektuese e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregullores komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujqësisë dhe Pylltarisë.
- Menagjimenti i Ndërmarrjes NPK "Higjiena" menagjon me operimet të NPK "Higjiena" duke ushtruar kompetenca ekzekutive.

2. Konteksti lokal

2.1. Përshkrim i situatës në Komunë

Komuna e Deçanit ka një pozitë mjaftë të mirë gjeografike. Komuna ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit. Në perëndim kufizohet me Republikën e Shqipërisë dhe Malin e Zi, në veri kufizohet me Komunën e Pejës, në jug-lindje kufizohet me Komunën e Gjakovës, në jug dhe perëndim kufizohet me Komunën e Junikut. Deçani ka një sipërfaqe prej 288.40 km² (28.840 ha) e cila kombinon relievin maloro-kodrinor në pjesën perëndimore dhe atë rrafshinor në pjesën lindore.

Harta Nr. 1: Pozita gjeografike e komunës së në Kosovë



Komuna e Deçanit është mjaft e pasur me pasuri natyrore. Kompleksi i vargmaleve të Beshkëve të Nemuna është i pasur me florë dhe faunë të zhvilluar, si dhe me reliev karakteristik të llojit të veçantë. Në të njëjtin kompleks hasim edhe në llojlojshmërinë e shkëmbinjve dhe të mineraleve të pastuduara sa duhet. “Pishat e Deçanit” me sipërfaqe prej 15 Ha gëzon nga MMPH statusin special të peizazhit të Mbrojtur. Në territorin e Deçanit gjenden lokacionet tjera me interes për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit si: Maja e Ropsit me sipërfaqe prej 20.00 Ha e cila paraqet një Rezervat bimor i llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut si dhe Kozhnjeri me sipërfaqe 150 Ha i cili përfaqëson Rezervat shtazor i llojit dhia

e egër (*Rupicapra rupicapra* L.).

Lugina fluvialo g-glaciale e Lumbardhit të Deçanit, e cila prej burimit deri në vendderdhje në Drinin e Bardhë, me gjatësi 40 km, ka një pjerrtësi vertikale rreth 2000 m. E tërë hapësira rreth Deçanit, gjegjësisht në mallet që e rrethojnë, janë me liqene akullnajore dhe me lugina të lumenjve, të cilat kanë formë të grykës dhe janë shumë tërheqëse për vizitorë. Pyjet e llojlojshme, kullotat e shumta, fauna e pasur, ajri i freskët dhe i pastër malor i Alpeve Shqiptare, kanë mundësuar që Deçani të afirmohet si qendër rekreativo-turistike. Valorizimi turistik i Deçanit ka fituar renomenë e vet me ndërtimin e pushimorës rrëzë malit të rrethuar me pyje të pishave dhe të gështenjës. Në afërsi të pushimores gjendet gryka e Lumbardhit të Deçanit. Në të dalë të Lumbardhit prej grykës së vet është ndërtuar Manastiri i Deçanit. Kisha dhe manastiri nuk është i njohur vetëm për arkitekturën, lartësinë, dekorimin plastik të syllit romak në gurë me portalet rreth dritareve, por edhe pse është vendosur në një vend pitoresk.

Në kuadër të komunës përfshihen edhe këto vendbanime:

Tabela Nr. 1 Vendëbanimet në komunën e Deçanit

Nr. rendor	Emri i vendëbanimit	Nr. rendor	Emri i vendëbanimit
1	Baballoq	20	Llukë e Epërme
2	Beleg	21	Llukë e Ulët
3	Belle	22	Maznik
4	Carrabreg i Epërm	23	Papiq
5	Carrabreg i Ulët	24	Pobërxhë
6	Dashinoc	25	Pozhar


7	Deçan	26	Prapaqan
8	Drenoc	27	Prekolluk
9	Dubovik	28	Prilep
10	Dubravë	29	Rastavicë
11	Glogjan	30	Ratish i Epërm
12	Gramaçel	31	Ratish i Ulët
13	Hulaj	32	Sllup
14	Irnig	33	Strellc i Epërm
15	Isnig	34	Strellc i Ulët
16	Kodrall	35	Shaptej
17	Lëbushë	36	Voksh
18	Lumbardh	37	Vranoc i Vogël
19	Lloqan		

Ekzistojnë lidhjet e drejtpërdrejta magjistrale me Pejën, dhe Gjakovën, të cilat mundësojnë lidhje të ngushta për zhvillime ekonomike dhe kulturore rajonale. Nëpërmjet hekurudhës në Pejë lidhet me arterien kryesore ballkanike. Rruga automobilistike nëpër Pejë, ZhlebdueRozhajë bënë lidhjen më të shkurtër me Detin Adriatik. Duke qenë komunë kufitare me Republikën e Shqipërisë dhe Malin e Zi është një potencial i cili nëse shfrytëzohet mund të i jep hov zhvillimit ekonomik.

Në qytetin e Deçanit janë të koncentruara edhe funksionet qendrore të administratës, edukimit, shëndetësisë, kulturës, industrisë dhe tregtisë. Qytetet dhe fshatrat në rajon janë të lidhura me rrjet mjaft të mirë rrugësh. Nëpër territorin e Komunës rrjedhin lumenj dhe përrenj të shumtë. Lumi kryesor është ai i Lumëbardhit, i cili kalon pranë qytetit tëDeçanit.

2.2. Të dhëna mbi vendbanimet në Komunë dhe popullësinë

Harta Nr. 2: Vendbanimet në komunën e Deçanit²



Sipas Censusit të vitit 2011, komuna e Deçanit ka 37 vendbanime me një numër total të popullsisë prej 40,019 banorë, dhe të amvisërive prej 5,887. Në tabelën në vijim është paraqitur popullsia e Deçanit sipas regjistrimit të vitit 2011 (të dhënat nga ASK-ja) dhe vlerësimi për popullësinë në vitet që do të mbulohen me këtë plan. Llogaritja e popullësisë për vitet 2018-2022 është bërë bazuar në të dhënat e publikimit të ASK "Vlerësim Popullsia e Kosovës 2016", që rezultojnë

me një rritje të popullësisë me indeks 1.14% në vit, ku merret parasysh rritja e natyrshme, vdekjet, dhe emigrimi jashtë vendit. Sipas parashikimeve të lartë përmendura, komuna e Deçanit në vitin 2018 pritet të ketë 40,670 banorë apo 5,983 amvisëri.

Tabela Nr. 2: Numri i popullsisë dhe amvisërive në komunën e Deçanit

Nr.	Zona Kadastrale	2017		2018		2022	
		Numri i Popullates	Numri i Amviserive	Numri i Popullates	Numri i Amviserive	Numri i Popullates	Numri i Amviserive
1	Baballoq	1,611	257	1,624	259	1,677	268

²Burimi GIZ

2	Beleg	833	131	839	132	867	136
3	Belle	8	2	8	2	8	2
4	Carrabreg i Epërm	1,458	207	1,470	208	1,518	215
5	Carrabreg i Ulët	2,076	304	2,093	307	2,161	317
6	Dashinoc	301	42	304	43	314	44
7	Deçan	3,834	607	3,865	612	3,992	632
8	Drenoc	1,054	170	1,063	172	1,098	177
9	Dubovik	1,069	142	1,077	143	1,113	148
10	Dubravë	280	43	283	44	292	45
11	Glllogjan	992	140	1,000	141	1,033	146
12	Gramaçel	1,106	161	1,115	163	1,151	168
13	Hulaj	159	31	161	32	166	33
14	Irzniq	1,753	243	1,767	245	1,825	253
15	Isniq	3,902	583	3,934	587	4,063	607
16	Kodrali	815	137	821	138	848	143
17	Lëbushë	1,154	170	1,164	172	1,202	177
18	Lumbardh	723	116	729	117	753	121
19	Lloqan	503	92	507	92	524	96
20	Llukë e Epërme	1,463	191	1,475	192	1,523	198
21	Llukë e Ulët	510	75	514	75	531	78
22	Maznik	451	61	454	62	469	64
23	Papiq	175	25	177	25	183	26
24	Pobërzhë	1,325	194	1,335	195	1,379	202
25	Pozhar	427	66	431	66	445	68
26	Prapaqan	746	110	752	111	777	114
27	Prekolluk	290	46	293	47	302	48
28	Prilep	2,183	295	2,200	298	2,272	308
29	Rastavicë	1,248	161	1,258	163	1,299	168
30	Ratish i Epërm	212	34	213	35	220	36
31	Ratish i Ulët	565	58	569	59	588	61
32	Sllup	341	44	344	45	355	46
33	Strellc i Epërm	3,374	510	3,401	514	3,513	531
34	Strellc i Ulët	2,131	307	2,148	310	2,219	320
35	Shaptej	596	81	601	81	620	84
36	Voksh	575	83	579	83	598	86
37	Vranoc i Vogël	102	13	103	13	106	14
Total:		40,019	5,887	40,670	5,983	42,005	6,179

2.3. Të dhëna mbi sektorët tjerë

2.3.1. Arsimi

Procesi edukativo-arsimor në komunën e Deçanit zhvillohet në tre nivele: arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm. Në kuadër të këtij sistemi funksionojnë 24 institucione shkollore të arsimit fillor dhe tre të atij të mesëm me profil gjimnaz dhe ekonomi.

2.3.2. Shëndetësia

Kujdesi primar shëndetësor në Deçan funksionon mbi konceptin e “Mjekësisë Familjare” the operimin e vetë e mbështet në menaxhimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), dhe punkte shëndetësore në nivel fshatrash.

Gjendja e përgjithshme e shëndetësisë në Deçan karakterizohet me mungesa të përditshme të mjeteve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve për pacientët

Tabla Nr.3: Institucionet shëndetësore në komunën e Deçanit:

Nr.	Emri i institucionit shëndetësor	Vendëndodhja
1	Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF)	Deçan
2	Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF)	Isniq, Strellc i Epërm dhe Irzniq
3	Njësi shëndetësore apo ambulanca	Prapaqan, Pobergjë, Prelep, Lumbardh, Ratish dhe Gramaqel

2.3.3. Administrata publike dhe lokale

Shërbimet administrative kryesore në nivel të komunës janë të përqendruara në Deçan, ku përfshihen shërbimet e Kuvendit Komunal me zyret përkatëse, Qendra për Punë Sociale (në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale), Qendra për Regjistrim (në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme), Ndertesa e Gjykatës, Post-Telekomi, Zyra për komunitete, stacioni policor, Zyra për punësim, Shërbimet e Zjarrefikësve, Ujësjellësi, Sistemi i Ujitjes “Drini i Bardhe”, OJQ-të, filialet e disa prej bankave komerciale, etj.

Komuna e Deçanit përveq Zyrës së Kryetarit ka 11 drejtorate sa vijon:

- Drejtoria për Administratë
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Drejtoria për Arsim,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural
- Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
- Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike
- Drejtoria për inspeksion
- Drejtoria për Gjeodozi dhe Kadastër
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

2.3.4. Bizneset, burimet natyrore dhe turizmi

Ekonomia e komunës së Deçanit tradicionalisht ka qenë e bazuar në dy fusha dmth turizëm-hoteleri dhe bujqësi. Lufta e periudhës 1998-1999 e ka dëmtuar në veqanti komunën e Deçanit ku është shkatërruar pothuaj në tërësi infrastruktura bujqësore. Në periudhën e pasluftës janë bërë disa përpjekje për të rimëkëmbur ekonominë. Përderisa sektori i turizmit po e merrë ngadal veten sektori i bujqësisë nuk ka arritur të rimëkëmbet dhe në përgjithësi për nga aktiviteti është nën nivelet e paraluftës.

Ekonomia e sotme e Deçanit është dinamike dhe e bazuar në sektorin privat si bartëse kryesore e zhvillimit ekonomik të komunës. Në Komunën e Deçanit aktivitetin ekonomik e zhvillojnë 1,353 biznese kryesisht biznese të vogla me karakter shërbyes. Komuna e Deçanit për shkak të karakteristikave të terrenit dhe burimeve hidrike është atraktive për gjenerimin e energjisë elektrik përmes hidroenergjisë. Në këtë drejtim konzorciumin Kelag nga Austria në partneritet me komunën ka ndërtuar tre hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Lumëbardh dmth “Lumëbardhi II”, “Belleja” dhe “Deçani”, me kapacitet prodhues prej 23 MGW energji me një vlerë investimi prej 55 milionë €.

Në komunën e Deçanit ka rezerva të konsiderueshme të granitit dhe mermerit natyrore të një cilësie të mirë i cili eksploatohet për momentin në kapacitete modeste.

Deçani posedon resurse të shumta natyrore, e që janë të favorshme për zhvillimin e turizmit, sidomos resurset që janë në masivin e Bjeshkëve të Nemuna. Poashtu manastiri mesjetar është një atraksion në vete dhe i njëjti mundë të jetë në funksion të tërheqjes së turistëve respektivisht zhvillimit të sektorit të turizmit.

3. Menaxhimi i mbeturinave

3.1. Detyrat dhe përgjegjësitë në menaxhimin e mbeturinave

3.1.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komunës

Shërbimet komunale, në këtë rast shërbimet e menaxhimit të mbeturinave janë detyrë e rezervuar për nivelin lokal – komunat. Brenda komunës, kjo përgjegjësi i është përcaktuar Departamenti për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbimeve Publike (DMSHShP). Detyrat dhe përgjegjësitë e DMSHShP-së kundër menaxhimit të mbeturinave janë si në vijim:

- Të hartojë planin lokal për administrimin e mbeturinave.
- Të hartojë raporte vjetore mbi administrimin e mbeturinave, të cilat i dorëzojnë në Ministri, në tremujorin e parë të vitit vijues.
- Të rregulloj, zbatoj dhe organizoj administrimin e mbeturinave në territorin e komunës.
- Të merr pjesë në lëshimin e vendimeve për ndërtimin e objekteve për trajtimin e mbeturinave.
- Të kryej punë të tjera të parashtruara me këtë ligj, si dhe akte të tjera për administrim të mbeturinave.
- Të caktojë tarifën për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave.
- Aprovon orarin dhe kohën e propozuar për bartjen e mbeturinave. Organizon akcione të ndryshme për pastrimin e ambientit jetësor.
- Përcjell procedurën e pastrimit të parqeve, sipërfaqeve të gjelbëruara.
- Bënë menaxhimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha shesheve që i përkasin komunës
- Bënë mirëmbajtja e varrezave dhe lapidareve, etj.

Sipas Ligjit mbi Mbeturinat Komuna e Deçanit është përgjegjëse vetëm për mbeturinat komunale, ndërsa menaxhimin i mbeturinave të rrezikshme si ato industriale, medicinale, , etj është përgjegjësi e nivelit qendror.

3.1.2. Departamenti për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbimeve Publike DMSHShP

Përgjegjësia në menaxhimin e mbeturinave për komunën e Deçanit siq u cek më lartë bie mbi Departamenti për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbimeve Publike. DMSHShP ka të angazhuar 5 zyrtarë dhe njëri nga këta është i dedikuar për menaxhimin e mbeturinave. Me vendim të kryetarit të Kuvendit Komunal Nr. 02-6066 të datës 06. 03. 2018 është themeluar grupi punues për identifikimin e problemeve dhe mbështetje nëpërgaditjen e planit të menaxhimit të mbeturinave në përbërje sa vijon:

- Izet Zenuni, Drejtor i Drejtorisë për MSH dhe SHP, kryetar,
- Lendim Kuçi Drejtoria për Administratë, zëvendës kryetar,
- Xhevat Lufaj, Drejtoria për MSH dhe SHP, anëtar,
- Xheladin Malaj, Drejtoria për Urbanizëm dhe PH, anëtar,
- Vlora Agaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, anëtare,
- Ajne Ibërhyasaj, Drejtoria për Inspekcione, anëtare,
- Selim Bozhdaraj, NPK Higjiena, anëtar,
- Ali Tahirsylaj, Drejtoria për Administratë, anëtar,
- Dafina Cacaj, Zyra e Kryetarit, anëtare,
- Mërgim Panxhaj, OJQ ECO- Deçan

DMSHShP përcjell veprimtarinë e ofruesit publik të shërbimit të mbeturinave NPK "Higjiena" dhe intervenon sipas nevojë për të përmbushur objektivat e paracaktuara. DMSHShP identifikon nevojat për mbështetje të operatorit sidomos në projekte kapitale.

3.1.3. Detyrat dhe përgjegjësitë e NPK "Higjiena"

Ndërmarrja Publike Komunale (NPK) "Higjiena" vepron në komunën e Deçanit duke qenë përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të

mbeturinave komunale. Statusit i NPK Higjiena Neni 4, përcakton veprimtaritë e sajë sa vijon: Ndërmarrja përmes veprimtarisë së saj do të:

- Siguroj efikasitetin e mbledhjes së mbeturinave, riciklimin dhe depozitim të tyre në pajtueshmëri me standardet shëndetësore, sigurinë dhe ruajtjen e ambientit,
- Siguroj efikasitetin e udhëheqjes dhe mirëmbajtjes së deponimit të mbeturinave inerte në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi Komunal,
- Ndërmerr masa të tilla të cilat do të jenë të domosdoshme për pastrimin dhe larjen e rrugëve dhe vendeve tjera publike,
- Ndërmerr masa të cilat janë të domosdoshme për krijimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike dhe gjelbërimeve,
- Ndërmerr masa të nevojshme për mirëmbajtjen e varrezave të cilat janë dhënë në menaxhim,
- Grumbullojë mbeturina jo-shtëpiake duke përfshirë mbeturinat industriale ndërtimore, me përjashtim të atyre të rrezikshme

3.2. Shkalla e mbulueshmërisë së territorit me shërbime

Përcaktimi i shkallës së mbulimit me shërbim të grumbullimit të mbeturinave është një detyrë mjaft komplekse për shkak të ekzistencës së të dhënave kontradiktore sa i përket popullatës që graviton në territorin administrativ të komunës. Komuna edhe pse formalisht përgjegjëse për ofrimin e shërbimit nuk ka të dhëna vetanake se sa familje realisht gjenerojnë mbeturina dhe sa prej tyre pranojnë shërbimin. Nga ana tjetër Kompania ka të dhëna se sa familje pranojnë shërbimin nga databaza e faturimit nga NPK Higjiena por ky regjistër ka të meta meqë i njëjti nuk azhurnohet si duhet.


Territori i komunës së Deçanit mbulohet me shërbime të grumbullimit të mbeturinave si në tabelën në vijim. Mbulimi me shërbime është llogaritur duke përdorë numrin e përgjithshëm të popullatës dhe duke e krahasuar atë me numrin e popullatës së faturuar (shërbyera). Kështu që nga 40,343 banorë në komunën e Deçanit, 11,229 prej tyre apo 27.8 % marrin shërbime të grumbullimit të mbeturinave. Përveq në qytetin e Deçanit shërbimi ofrohet edhe në 18 vendbanime tjera me shkallë mbullimi e cila varion prej 93.1% në Voksh e deri 0.8% Irzniq (vetëm dy shtëpi janë të shërbyera). Në vetë qytetin e Deçanit shkalla aktuale e mbulimit është 80.2%.

Tabela Nr. 4: Mbulimi me shërbim për popullatë

		Numri i popullatës	Numri i Amviserive	Numri popullatës së shërbyer	Amviserite e shërbyera	Mbulimi me shërbim
Nr.	Komuna Deçan	40,343	5,935	11,229	1,677	27.8%
1	Baballog	1,611	257	-	-	0.0%
2	Beleg	833	131	604	95	72.5%
3	Belle	8	2	-	-	0.0%
4	Carrabreg i Epërm	1,458	207	1,136	161	77.9%
5	Carrabreg i Ulët	2,076	304	1,282	188	61.8%
6	Dashinoc	301	42	-	-	0.0%
7	Deçan	3,834	607	3,077	487	80.2%
8	Drenoc	1,054	170	836	135	79.2%
9	Dubovik	1,069	142	-	-	0.0%
10	Dubravë	280	43	-	-	0.0%
11	Glllogjan	992	140	-	-	0.0%
12	Gramaçel	1,106	161	-	-	0.0%
13	Hulaj	159	31	102	20	64.0%
14	Irzniq	1,753	243	14	2	0.8%
15	Isnig	3,902	583	114	17	2.9%
16	Kodralli	815	137	-	-	0.0%
17	Lëbushë	1,154	170	217	32	18.8%

18	Lumbardh	723	116	-	-	0.0%
19	Lloqan	503	92	422	77	83.9%
20	Llukë e Epërme	1,463	191	906	118	61.9%
21	Llukë e Ulët	510	75	-	-	0.0%
22	Maznik	451	61	-	-	0.0%
23	Papiq	175	25	-	-	0.0%
24	Pobërxhë	1,325	194	842	123	63.5%
25	Pozhar	427	66	52	8	12.2%
26	Prapaqan	746	110	-	-	0.0%
27	Prekolluk	290	46	-	-	0.0%
28	Prilep	2,183	295	-	-	0.0%
29	Rastavicë	1,248	161	-	-	0.0%
30	Ratish i Epërm	212	34	191	31	90.4%
31	Ratish i Ulët	565	58	492	51	87.2%
32	Sllup	341	44	315	41	92.4%
33	Strellc i Epërm	3,374	510	93	14	2.7%
34	Strellc i Ulët	2,131	307	-	-	0.0%
35	Shaptej	596	81	-	-	0.0%
36	Voksh	575	83	535	77	93.1%
37	Vranoc i Vogël	102	13	-	-	0.0%

Harta Nr. 4 dhe 5: Shkalla e mbulimit me shërbim



Kjo shkallë është shumë e ulët dhe e njëjta duhet të rritet në periudhën planifikuese për faktin se mosmbulimi me shërbim rezulton në krijimin e deponive ilegale në të cilat hidhen mëpastaj mbeturina nga demolimet, goma, bateri dhe rrjedha tjera të mbeturinave.



Hedhja e mbeturinave në mënyrë të papërshtatshme zakonisht bëhet në brigjet e lumenjëve dhe në pika të ulët gjeografike qka ndikon në ndotjen e ujrave sipërfaqësore dhe akuifereve, ndotjen e tokës, vërshime e kështu me radhë.

Në komunë janë të regjistruara 1.353 biznese, nga të cilat 251 (apo 18.6%) faturohen për shërbime të grumbullimit të mbeturinave. Sa i përket institucioneve, në Deçan janë gjithsej 34 dhe që të gjitha faturohen për shërbime të grumbullimit të mbeturinave.

Tabela Nr. 5: Mbulimi me shërbime nga NPK "Higjiena" në komunën e Deçanit

Nr.	Zona Kadastrale	Amvisëri					Biznese			Institucione		
		Numri i Popullates	Numri i Amviserive	Amviserite e shërbyera	Popullata e shërbyer	Mbulimi me shërbim	Rexhistruara	Shërbyera	% e mbulimit	Aktive	Shërbyera	% e mbulimit
1	Baballog	1,611	257	-	-	0.0%	20	1	5.0%	-	-	-
2	Beleg	833	131	95	604	72.5%	10	-	-	-	-	-
3	Belle	8	2	-	-	0.0%	1	-	-	-	-	-
4	Carrabreg i Epërm	1,458	207	161	1,136	77.9%	43	-	-	-	-	-
5	Carrabreg i Ulët	2,076	304	188	1,282	61.8%	42	1	2.4%	-	-	-
6	Dashinoc	301	42	-	-	0.0%	2	-	-	-	-	-
7	Deçan	3,834	607	487	3,077	80.2%	675	244	36.1%	33	33	100%
8	Drenoc	1,054	170	135	836	79.2%	24	-	-	-	-	-
9	Dubovik	1,069	142	-	-	0.0%	22	-	-	-	-	-
10	Dubravë	280	43	-	-	0.0%	6	-	-	-	-	-
11	Glllogjan	992	140	-	-	0.0%	22	-	-	-	-	-
12	Gramaçel	1,106	161	-	-	0.0%	17	-	-	-	-	-
13	Hulaj	159	31	20	102	64.0%	2	-	-	-	-	-
14	Irznig	1,753	243	2	14	0.8%	42	-	-	-	-	-
15	Isniq	3,902	583	17	114	2.9%	106	2	1.9%	-	-	-
16	Kodrali	815	137	-	-	0.0%	8	-	-	-	-	-
17	Lëbushë	1,154	170	32	217	18.8%	27	-	-	-	-	-
18	Lumbardh	723	116	-	-	0.0%	11	-	-	-	-	-
19	Llogan	503	92	77	422	83.9%	10	-	-	-	-	-
20	Llukë e Epërme	1,463	191	118	906	61.9%	24	2	8.3%	-	-	-
21	Llukë e Ulët	510	75	-	-	0.0%	3	-	-	-	-	-
22	Maznik	451	61	-	-	0.0%	8	-	-	-	-	-
23	Papiq	175	25	-	-	0.0%	2	-	-	-	-	-
24	Pobërzhë	1,325	194	123	842	63.5%	21	-	-	-	-	-
25	Pozhar	427	66	8	52	12.2%	10	-	-	-	-	-
26	Prapaqan	746	110	-	-	0.0%	8	-	-	-	-	-
27	Prekolluk	290	46	-	-	0.0%	3	-	-	-	-	-
28	Prilep	2,183	295	-	-	0.0%	40	1	2.5%	-	-	-
29	Rastavicë	1,248	161	-	-	0.0%	24	-	-	-	-	-
30	Ratish i Epërm	212	34	31	191	90.4%	14	-	-	-	-	-
31	Ratish i Ulët	565	58	51	492	87.2%	-	-	-	-	-	-
32	Sllup	341	44	41	315	92.4%	7	-	-	-	-	-
33	Strellc i Epërm	3,374	510	14	93	2.7%	55	-	-	-	-	-
34	Strellc i Ulët	2,131	307	-	-	0.0%	25	-	-	-	-	-
35	Shaptej	596	81	-	-	0.0%	8	-	-	-	-	-
36	Voksh	575	83	77	535	93.1%	9	-	-	-	-	-
37	Vranoc i Vogël	102	13	-	-	0.0%	2	-	-	-	-	-
Total		40,343	5,935	1,677	11,229	27.8%	1,353	251	18.6%	33	33	100%

Hartat Nr. 6 dhe 7: Zonat aktuale të shërbimit në komunën e Deçan



Ekziston një laramani sa i përket zonave dhe orarit të shërbimit. Në përgjithësi qyteti i Deçanit ndahet në skemë zonimi të komplikuar i cili diktohet nga orari i shërbimit. Në përgjithësi në zonën e qendrës urbane e cila përfshinë ndërtesa shumëkatëshe të shërbyera me kontejnerë 1.1 m³ shërbimi kryhet një herë në ditë ndërsa për zonën periurbane të qytetit me shtëpi individuale si dhe fshatrat përreth shërbimi kryhet një herë në (dy) javë. Sa i përket bizneseve pa kontrata jashtë zonës së qendrës shërbimi kryhet tre herë në dy javë ndërsa bizneset me kontrata shërbimi kryhet sipas orarit të kontratës.

3.3. Sistemi ekzistues i menaxhimit të mbeturinave

Grumbullimi i mbeturinave në komunën e Deçanit bëhet përmes sistemit derë më derë (kontejner 120 l dhe qese plastike), kontenjereve të përbashkët (1.1m³) si dhe kontejnerëve me kontratë (1.1m³). Shërbimi derë më derë kryhet nëpërmes kontenjereve 120 lit dhe qese plastike dhe i njëjti bëhet në gjithë fshatrat e shërbyera dhe një pjesë të qytetit. Ndërsa shërbimi me kontenjerë të përbashkët (në pjesën e qendrës së qytetit) dhe me kontratë kryhet nëpërmes kontenjerëve 1.1m³.

Tabela Nr. 6: Mënyra e ofrimit të shërbimeve nga NPK "Higjiena"

Nr.	Vendbanimet	Mbulimi %	Mënyra e shërbimit	Nr.	Vendbanimet	Mbulimi %	Mënyra e shërbimit
1	Baballog	0.0%	S'ka shërbim	20	Llukë e Epërme	61.9%	120 l, qese
2	Beleg	72.5%	120 l, qese	21	Llukë e Ulët	0.0%	S'ka shërbim
3	Belle	0.0%	S'ka shërbim	22	Maznik	0.0%	S'ka shërbim
4	Carrabreg i	77.9%	120 l, qese	23	Papiq	0.0%	S'ka shërbim
5	Carrabreg i Ulët	61.8%	120 l, qese	24	Pobërxhë	63.5%	120 l, qese
6	Dashinoc	0.0%	S'ka shërbim	25	Pozhar	12.2%	120 l, qese
7	Deçan	80.2%	1.1 m ³ , 120l, qese	26	Prapaqan	0.0%	S'ka shërbim
8	Drenoc	79.2%	120 l, qese	27	Prekolluk	0.0%	S'ka shërbim
9	Dubovik	0.0%	S'ka shërbim	28	Prilep	0.0%	S'ka shërbim
10	Dubravë	0.0%	S'ka shërbim	29	Rastavicë	0.0%	S'ka shërbim
11	Glllogjan	0.0%	S'ka shërbim	30	Ratish i Epërm	90.4%	120 l, qese
12	Gramaçel	0.0%	S'ka shërbim	31	Ratish i Ulët	87.2%	120 l, qese
13	Hulaj	64.0%	120 l, qese	32	Sllup	92.4%	120 l, qese
14	Irzniq	0.8%	120 l, qese	33	Strelc i Epërm	2.7%	120 l, qese
15	Isniq	2.9%	120 l, qese	34	Strelc i Ulët	0.0%	S'ka shërbim
16	Kodrali	0.0%	S'ka shërbim	35	Shaptej	0.0%	S'ka shërbim
17	Lëbushë	18.8%	120 l, qese	36	Voksh	93.1%	120 l, qese
18	Lumbardh	0.0%	S'ka shërbim	37	Vranoc i Vogël	0.0%	S'ka shërbim
19	Lloqan	83.9%	120 l, qese				

Në qytetin e Deçanit ekzistojnë 15 pika të grumbullimit me gjithsejtë 34 kontejnerëve 1.1 m³, dmth në pika grumbulluese ka prej një deri tre kontejnerë të vendosur. Numri i kontejnerëve është i pamjaftueshëm sidomos për amvisëritë gjë që rezulton nëdeponi të shumta të egra si brenda qytetit ashtu edhe në pjesët periferike.

Tabela Nr. 7: Shpërndarja e kontejnerëve të përbashkët

Përdorimi	Pika grumbullimi	Lloji i kontejnerëve dhe numri		Totali
		1.1 m ³	7.0 m ³	
Institucione	22	24	0	24
Amvisëri	2	4	0	4
Biznese	7	22	0	22
Biznese të mëdha	1	2	0	2
Totali	32	52	0	52

Kontenjerët 1.1m³ janë në gjendje jo të mirë për shkak të amortizimit të tyre. Shumica e tyre nuk kanë kapak funksional, nuk pastrohen nga operatori dhe në disa raste ju vhihet zjarri nga qytetarët e pandërgjegjshëm.

Foto Nr. 1: Deponia ilegale brenda qytetit



3.3.1. Frekuenca e Shërbimit

NPK “Higjiena” bënë grumbullimin e mbeturinave më këtë frekuencë të shërbimeve: në qytet shërbimi ofrohet çdo ditë nga 08:00 – 16:00. Gjatë sezonit të verës kur sasia e mbeturinave rritet për shkak të arrdhjes së qytetarëve nga diaspora shërbimi ofrohet edhe dy here në ditë. Bizneset dhe institucionet me kontrata të veçanta shërbehen në bazë të orarit të kontratave dhe në bazëtë mbushjes së kontejnerëve.

Ndërsa në fshatra shërbimi bëhet me kontejnerë 1.1 institucionet dhe disa biznese me kontrata. Ekonomitë familjare shërbehen me 120l ose me qese. Mbeturinat e grumbulluara transportohen në deponinë në Sverkë të thatë të menagjuar nga NPK Ambijenti Pejë.

3.4. Sasia dhe lloji i mbeturinave

3.4.1. Sasia ekzistuese e mbeturinave

Sipas raportit për Mbeturina dhe Kimikate të AMMK-së, sasia e mbeturinave të gjeneruara për kokë banori në Kosovë është si në vijim:

- për vitin 2008 është 167 kg, apo 0.5 kg në ditë;
- për vitin 2009 është 193 kg, apo 0.5 kg në ditë;
- për vitin 2010 është 297 kg, apo 0.8 kg në ditë;
- për vitin 2011 është 335 kg, apo 0.9 kg në ditë; dhe
- në vitin 2012 është 334 kg, apo 0.9 kg në ditë.

Këto të dhëna sugjerojnë për një rritje të ndjeshme të sasisë së mbeturinave. Nga viti 2008 në 2009 kemi rritje për 15%; nga viti 2009 në 2010 kemi rritje për 50%; nga viti 2010 në 2011 kemi rritje për 12%; ndërsa nga viti 2011 në 2012 vërehet një trend i stabilizimit. Të dhënat për vitin 2009 ka të ngjarë se nuk kanë besueshmëri të lartë për faktin se sistemi i raportimit të grumbullimit të mbeturinave është përcjell me dobësi në periudhën fillestare..

Duke marrë parasysh që grumbullimi i mbeturinave në komunën e Deçanit bëhet në mënyrë të përbashkët për amvisëri, biznese dhe institucione, nuk ekzistojnë të dhëna tëvecanta për cdo kategori për sasi të mbeturinave. Sasia mesatare e mbeturinave të grumbulluara dhe të transportuara në deponinë Sverka e thatë është 3,380 t (për vitin 2017).

Tabela Nr. 8: Gjenerimi i mbeturinave ne komunë të Deçanit

Numri i amvisërive të shërbyera	Numri i banorëve të shërbyer	Sasia e mbeturinave: amvisëri, biznese dhe institucione	Sasia mesatare e gjenerimit të mbeturinave për kokë banori		
		javë	vit	vit	ditë
1,677	11,229	65 t	3,380 t	301 kg	0.82 kg

Sipas këtyrë të dhënave sasia e mbeturinave të gjeneruara për kokë banori për vitin 2017 është 301kg, ndërsa për ditë është 0.82kg. Nga këto rezultate vërejmë që komuna e Deçanit nuk dallon ndjeshëm nga niveli qendror sa i përket shkallës së gjenerimit të mbeturinave duke gjeneruar 5% më pak mbeturina për kokë banori nga mesatarja e gjenerimit të mbeturinave për tërë Kosovën.

3.4.2. Sasia e parashikuar e rritjes së mbeturinave 2018 - 2022

Parashikimet për rritjen e popullsisë në komunën e Deçanit janë bazuar në të dhënat e Bankës Botërore, dhe raportimet makroekonomike, që rezultojnë me një rritje të popullsisë me indeks 0.8% në vit, ku merret parasysh rritja e natyrshme por edhe migrimi dhe emigrimi. Prandaj sipas kësaj llogaritje, popullsia e Deçanit ka një trend rritje sikurse që është prezentuar në tabelën më poshtë. Për planifikimet e këtij plani ne do të marrim parasysh rritjen nga viti 2016 – 2022:

Tabela Nr. 9: Projektioni i gjenerimit të mbeturinave ne komunën e Deçanit

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i Popullates	40,343	40,670	41,000	41,332	41,667	42,005
Gjenerimi i Mbeturinave për kokë banori kg/pcp/ditë	0.82	0.84	0.85	0.87	0.89	0.9
Gjenerimi Vjetore i Mbeturinave per tere popullaten ton	12,075	12,469	12,720	13,125	13,536	13,799
Gjenerimi Ditore i Mbeturinave ton	33.1	34.2	34.9	36.0	37.1	37.8

Sipas këtyre parashikimeve rezultojnë që numri i banorëve në komunën e Deçanit në vitin 2022 do të rritet për 4.1% nga numri aktual. Në vitin 2022 parashikohet që komuna e Deçanit të ketë 42,005 banorë.

Sipas të dhënave nga Master Plani për Menaxhim të Mbeturinave³, raportohet se konsumi i familjeve në Kosovë në pesë vitet e fundit është rritur 10%. Nga kjo e dhënë supozohet që për 5 vitet e ardhshme sasia e mbeturinave në Kosovë, respektivisht në komunën e Deçanit do të rritet për 10%, apo përafërsisht 2% për vit.

Nëqoftëse kësaj rritje i shtojmë edhe rritjen e popullsisë për 1.14% në vit, rritjen e konsumit për 2% dhe mbulimin me 100% të shërbimeve atëherë sasia e mbeturinave do të rritet për 203%. Nga tabela më poshtë vërejmë që parashikimet për rritje të sasisë së mbeturinave për vitin 2016 do të jenë 277 kg/vit dhe 0.76 kg.ditë për kokë banorë, ndërsa në vitin 2022 sasia do të arrijë kuotën prej 328 kg/vit apo 0.90kg/ditë për kokë banori.

3.4.3. Përbërja e mbeturinave

Përbërja e mbeturinave është përcaktuesi tjetër i rëndësishëm krahas sasisë së gjenerimit të mbeturinave. Përbërja e mbeturinave është informatë me rëndësi e cila mund të përdoret për planifikimin e aktiviteteve të ndarjes, ripërdorimit, riciklimit të mbeturinave si dhe

³Master Plani për Menaxhim të Mbeturinave, Zyra e Komisionit Evropian, Kosovë

gjenerimit të energjisë termale. Kjo informatë është poashtu e rëndësishme për dizajnimin e deponive si dhe emetimin e gazrave me bazë karboni dhe gazrave tjera me efekt serë.

Deri në momentin aktual nuk është zbatuar ndonjë hulumtim apo analizë e përbërjes së mbeturinave për komunën e Deçanit. Megjithatë analiza të përbërjes së mbeturinave janë bërë nga organizata donatore që veprojnë në Kosovë, GIZ, JICA dhe Zyra e Komisionit Evropian. Këto analiza janë bërë me shtrirje gjeografik e cila përfshinë gjithë territorin e Kosovës. Analiza më e fundit e këtij lloji është punuar nga projekti i financuar nga Zyra e Komisionit Evropian – Master Plani për Menaxhim të Mbeturina, rezultatet e së cilës janë përdorur si bazë për të përcaktuar përbërjen aktuale të mbeturinave si dhe për të parashikuar përbërjen e mbeturinave përgjatë periudhës projektuese 2017-2021 për komunën e Deçanit.

Tabela Nr. 10: Përbërja aktuale e mbeturinave në Kosovë dhe në Deçan⁴

	Lloji i mbeturines	Përbërja në nivel Kosove	Përbërja e mbeturinave të grumbulluara në Komunën e Deçanit t/vit 2017
1.	Organike	58.80%	7,346 t
2.	Plastike	12.40%	1,593 t
3.	Leter/Karton	9.00%	1,155 t
4.	Metal	1.00%	131 t
5.	Qelq	2.50%	320 t
6.	Dru	0.80%	101 t
7.	Tjere	15.50%	1,959 t
	Totali	100%	12,605 t

Nga analiza mund të konkludojmë pas mbeturinave organike, mbeturinat e plastikës pasuar nga mbeturina e letrës/kartonit janë mbeturinat që gjenerohen në masë të madhe në Kosovë. Komuna e Deçanit ka gjeneruar 12,605 ton në 2017 dhe nga përbërja e mbeturinave nga tabela Nr. 9 mund të thëmi që 15 - 20% mbeturina të gjeneruara në vit janë sasi potenciale për reciklim. Ndërsa 40 - 45% mbeturina në vit janë sasi potenciale për kompostim.

Me një menaxhim të mirëfillt 60 - 65% të mbeturinave mund të kompostohen apo reciklohen që paraqet një mundësi të mirë për zhvillimin e biznesit dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Përfitimi tjetër do të ishte në uljen e sasisë së mbeturinave të deponuara e cila do të lehtësonte barrën financiare të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave si dhe përfitime anësore të mbrojtjes së mjedisit.

3.4.4. Parashikimi i përbërjes së mbeturinave

Sic u cek më lartë analiza e parashikimit të përbërjes së mbeturinave (nivel Kosove) është marrë nga Master Plani për Menaxhim të Mbeturina. Kjo analizë është bazuar në rritjen ekonomike, ndryshimin e mënyrës së jetesës së qytetarëve (rritja e konsumit të ushqimit të pakëtuar), rritjen e numrit të banorëve dhe masat të cilat duhet të ndërmerren në të ardhmën për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e gjenerimit të mbeturinave.

⁴informatat e grumbulluara nga NPK "Higjiena

Tabela Nr. 11: Parashikimi i përbërjes së mbeturinave deri në vitin 2022

	2018		2019		2020		2021		2022	
Tipi i Mbeturinave	Kompozicioni %	Kompozicioni ton/vit	Kompozicioni %	Kompozicioni ton/vit	Kompozicioni %	Kompozicioni ton/vit	Kompozicioni %	Kompozicioni ton/vit	Kompozicioni i Mbeturinave %	Kompozicioni iton/vit
Organike	58.02%	7,667	57.76%	7,901 t	57.50%	8,046 t	57.10%	8,230 t	56.70%	8,359 t
Plastike	12.76%	1,686 t	12.88%	1,762 t	13.00%	1,819 t	13.18%	1,861 t	13.35%	1,929 t
Leter/Karton	9.24%	1,221 t	9.32%	1,275 t	9.40%	1,315 t	9.40%	1,345 t	9.40%	1,376 t
Metal	1.06%	140 t	1.08%	148 t	1.10%	154 t	1.10%	157 t	1.10%	161 t
Qelq	2.56%	338 t	2.58%	353 t	2.60%	364 t	2.65%	372 t	2.70%	388 t
Dru	0.80%	106 t	0.80%	109 t	0.80%	112 t	0.83%	115 t	0.85%	121 t
Tjere	15.56%	2,056 t	15.58%	2,131 t	15.60%	2,183 t	15.60%	2,233 t	15.60%	2,284 t
Totali:	100%	13,214 t	100%	13,679 t	100%	13,994 t	100%	14,314 t	100%	14,617 t

Nga parashikimi i përbërjes së mbeturinave vërejmë që përbërja e mbeturinave në vitin 2022 nuk do të ndryshojë në masë të madhe nga viti 2017. Me rritjen ekonomike pritet që një pjesë e popullatës së shërbyer do të ushqehet më shumë në restorane apo blejë ushqime të konservuara/ ambalazhuara si dhe do përgatit më pak ushqim në shtëpi. Poashtu nga zhvillimi i supozuar ekonomik pritet ngritja e konsumit për mallëra dhe produkte të gatshme. Kjo do të ndikojë në uljen e mbeturinave organike si dhe ngritjen e mbeturinave të ambalazhimit paketimit dhe ambalazhimit. Sipas këtij skenari të gjenerimit të mbeturinave parashihet:

- rënje e sasisë së mbeturinave organike për 2%,
- mbeturinat nga metalet do të mbesin përafërsisht në sasinë e njëjtë,
- mbeturinat nga qelqi do të pësojnë një ngritje të lehtë në sasi për 0.25%,
- mbeturinat e plastikës/PET do të ngriten për 1.1%,
- mbeturinat nga letra/kartoni do të pësojnë një ngritje të lehtë prej 0.75%, dhe
- mbeturinat nga druri do të qëndrojnë në sasi të përafërt.

3.5. Deponimi i mbeturinave

Shërbimi i deponimit të mbeturinave për komunën e Deçanit ofrohet nga KRM Ambijenti Pejë, përmes deponisë e cila gjendet në fshatin Sverkë e thatë në distancë prej 26 km në njërin drejtim. Edhe pse distanca nuk është gjitha e madhe për shkak të trafikut të ngarkuar rrugorë dhe infrastrukturës rrugore të pazhvilluar ka ndalesa dhe zgjatje të kohës së transportit e cila ngritë kostot e naftës si dhe nxjerr nga operativa kamionët e kompanisë. Për shërbimin e ofruar NPK Ambijenti ngarkon tarifën prej 3 Euro për çdo ton të mbeturinave komunale të deponuara apo gjysmën e tarifës që aplikohet nga Kompania për Menagjimin e Mbeturinave të Kosovës (KMDK).

Ligjërisht NPK Higjiena është e detyruar që të gjitha mbeturinat e grumbulluara ti deponoj në deponi. Për faktin se nuk ekzistojnë aktivitete të organizuara të ripërdorimit dhe riciklimit, e gjithë sasia e grumbulluar e mbeturinave në zonën e shërbimit deponohet. Ky fakt nënkupton që makineria për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave është e tejngarkuar e me të edhe kostoja e shërbimit.

Harta Nr. 8: Deponimi dhe transferi i mbeturinave




Fig Nr. 2 dhe 3: Deponia Komunale në Sferkë të thatë të menagjuar nga KRM Ambienti



3.6. Ndarja, Trajtimi dhe riciklimi

Në komunën e Deçanit nuk ka operatorë të licencuar i cili merret me aktivizimin e riciklimit të mbeturinave apo menagjimit të mbeturinave në përgjithësi. Si kudo në Kosovë aktiviteti i ndarjes së mbeturinave dhe grumbullimit të materialeve të riciklueshme zhvillohet nga sektori informal, respektivisht të një pjese të qytetarëve të komunës së Deçanit.

Ky komunitet zhvillon aktivitetin e tyre tek kontejnerët publik duke grumbulluar në mënyrëselektive metalin, letrën, kartonin, plastikën, materialet tjera të riciklueshme si dhe gjësendet tjera me vlerë.

Ky aktivitet nuk është i organizuar si duhet dhe i njëjti shkakton kokëqarje për grumbullimin e mbeturinave nga NPK Higjiena, për faktin se mbeturinat nxirren nga kontejnerët dhe shpërndahen përreth tyre. Përveq imazhit të padëshiruar që shfaq ky aktivitet në hapësira publike, i njëjti rrezikon shëndetin e vetë qytetarëve të angazhuar.

3.7. Rrjedhat tjera të mbeturinave

3.7.1. Mbeturinat shtazore

Bazuar në kornizën ligjore mbeturinat me prejardhje shtazore nuk duhet të përzihen me mbeturinat tjera komunale por duhen të grumbullohen dhe barten me mjet transportues të veqanta si dhe të deponohen në pika adekuate ku do të bëhej trajtimi i tyre.

Edhe pse mbeturinat shtazore grumbullohen me kontejnerë të veqantë ato nuk grumbullohen dhe transportohen me automjete të vecanta. Për më shumë deponimi dhe trajtimi i tyre nuk bëhet në mënyrë të vecantë nga mbeturinat komunale mirëpo ato përfundojnë së bashkë mbeturinat tjera.

Duke qenë se kontejnerët e përbashkët në zonën urbane janë të pambrojtur dhe se qasja tek ato është e pa penguar, ekzistojnë rastet kur gjeneruesit e mbeturinave shtazore apo një pjesë e qytetarëve të pandërgjegjshëm i hedhin mbeturinat shtazore në kontejnerë duke bërë përzierjen e tyre me mbeturinat komunale. Këto mbeturina në momentin e përzierjes nuk mund të konsiderohen më si mbeturina komunale por hyjnë në radhën e mbeturinave të rrezikshme deponimi i të cilave në masë mund të shkaktojë probleme serioze për deponitë sanitare dhe mjedisin përreth.

3.7.2. Mbeturinat medicinale

Mbeturinat medicinale janë përgjegjësi e nivelit qendror dhe se komuna nuk ka kompetenca për menaxhimin e tyre edhe pse të njëjtat shkaktojnë probleme serioze për vetë komunën dhe qytetarët e Deçanit.

Gjeneruesi më i madh i mbeturinave medicinale janë Qendrat e Mjekësisë Familjare, ordinancat dhe poliklinikat private, ordinancat stomatologjike dhe entitet tjera shëndetësore të cilave njëkohësisht pranojnë shërbimin e mbeturinave nga NPK Higjiena. Institucionet shëndetësore private i hedhin të gjitha mbeturinat përfshi mbeturinat medicinale në kontejnerët publik.



Sipas informatave nga QKMF në komunën e Deçanit, kjo QKMF posedon marrëveshje me Spitalin Regjional në Pejë për të trajtuar mbeturinat në këtë qendër. Komuna e Deçanit gjeneron rreth 30-40 kg mbeturina medicinale në javë, të cilat mbeturina transportohen në Spitalin Regjional të Pejës dy herë në javë.

3.8. Deponitë ilegale - mbeturinat ndërtimore

Sipas Ligjit për Mbeturina Nr. 04/60, deponitë ilegale definojnë si cdo pike e mbeturinave të cilat gjenden jashtëdeponive legale për mbeturina. Organizata ndërkombëtare GIZ, konkretisht projekti Shërbimet e Qendrueshme Komunale (ShQK) në muajin qershor 2017 ka organizuar një hulumtim në terren për të identifikuar numrin, llojin dhe lokacionin e deponive ilegale në komunën e Deçanit. Duke marrë parasysh që Ligji për Mbeturina nuk ofron ndonjë definicion më detal për deponi ilegale, projekti GIZ/ShQK ka dhënë definicionet si në vijim:

- Deponi ilegale definohet cdo pikë e mbeturinave që gjendet jashtëdeponise legale e cila tejkalon sasinë e 200l – apo sasi e mbeturinave që do të tejkalonte sasinë që do të nxinte njëkarroc dore.
- Deponitë ilegale ndahen sipas madhësisë si në vijim:
 - Deponi ilegale e vogël: 1 – 5 qese nga 200l apo 1 – 5 karroca dore
 - Deponi ilegale e mesme: 6 – 20 qese nga 200l apo 6 – 20 karroca dore
 - Deponi ilegale e madhe: më shumë së 20 qese nga 200l apo mbi 20 karroca dore
- Llojet e deponive ilegale:
 - Mbeturina komunale
 - Mbeturina ndërtimore
 - Mbeturina të rrezikshme
 - Mbeturina të vëllimshme

Hartat Nr. 9 dhe 10: Lokacionet e deponive ilegale në komunë




Rezultatet e hulumtimit në terren tregojnë që në komunën e Deçanit në qershor të vitit 2017 ekzistojnë 31 deponi ilegale (shih fotot me poshte). Shperndarja e tyre gjeografike është e rastesishme, pra nuk ka ndonjë strukturë të veçantë duke përfshirë Deçanin dhe fshatrat përreth si Llukë e Epërme dhe Ulët, Isniq, Lëbushë, Strelca e Epërm, etj.

Nga hulumtimi në terren rezulton që 31 deponi ilegale kanë karakteristikat në vijim:

- Të vogla: 3

- Të mesme: 6
- Të medha: 22

Grafiku Nr.1: Paraqitja skematike e deponive sipas madhësisë sipërfaqes dhe llojit të mbeturinave



4. Performanca e ofruesit të shërbimeve

4.1. Performanca Operative

4.1.1. Personeli i ofruesit të shërbimeve

Të dhënat në vijim i referohen stafit, makinerisë dhe aseteve të NPK Higjiena për fundin e vitit 2017. Numri i personelit të punësuar në mënyrë të përhershme në NPK “Higjiena” është 18 punonjës prej të cilëve 11 (apo 61%) janë staf direkt i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave dhe shërbimet tjera sekondare.

Numri i stafit të angazhuar (18) nxjerr në pah faktin se NPK Higjiena ka një joeficiencë të moderuar të personelit veqanërisht duke iu referuar stafit administrativ. Kjo është më se e qartë nëse i referohemi treguesve të performancës të stafit për njëmijë ton mbeturina të grumbulluara apo stafit për njëmijë banorë të shërbyer.

Tabela Nr. 12: Lista e punëtorëve të NPK “Higjiena”

Nr.	Pozita	Nr. i stafit të angazhuar
	Menagjmenti dhe Administrata	
1	KE	1
2	Inkasantet	2
3	inspektore	1
4	Faturist dhe arkatar	1
5	Të tjere	1
Total Menagjmenti dhe Administrata		6
Operativa (Grumbullimi dhe Pastrimi)		
6	Mbikëqyres	1
7	Shoferë	4
8	Punëtorë	6
Total Operativa (Grumbullimi dhe Pastrimi)		11
Sigurimi		
9	Rojëtarë	1
Total Sigurimi		1
Total stafi (personeli) i angazhuar		18

Tabela Nr.13: Performanca e stafit të NPK “Higjiena”

Nr. i Puntoreve total	18
Sasia e grumbullimit të mbeturinave	3,380 ton
Nr. Stafit/ '000 ton Mbeturina	5.32
Poullata e Shërbyer	11,229
Nr. Stafit/ '000 Popullata e Shërbyer	1.6

4.1.2. Pajisjet dhe makineritë

NPK Higjiena posedon një autopark modest i përbërë nga kamionë, traktorë dhe pajisje tjera për MMN. Vlenë të theksohet fakti se këto pajisje janë mjaft të amortizuara duke pësuar defekte të shpeshta si dhe joeficiente sa i perket harxhimit të karburantit.

Tabela Nr. 14: Lista e automjeteve dhe makinerisë së kompanisë “Higjiena”

Automjeti	Tabelat e regjistrimit	Njësia
Iveco	03-681-AR	1
MAN	03-469-CO	1
IVECO	229-KS-517	1
Eskavator	-	1
Traktor	-	1

Tabela Nr. 15: Mosha e makinerisë së kompanisë “Higjiena”

Pajisja	0-3 vjet	3-5 vjet	5-7 vjet	< 7 vjet	Total	Mosha mesatare
Kamionët	-	-	-	3	3	20.3 vjet
Traktorë	-	-	-	1	1	17 vjet

Jetëgjatësia mesatare e makinerisë për grumbullimin dhe transferin e mbeturinave është 20.3 vjet për kamionë dhe 17 vite për traktorë, qka nënkupton se makineria që moti ka përfunduar jetën ekonomike (të dobishme) dhe se duhen investime të konsiderueshme qoftë mjete vetanake, subvencione apo donacione që ky tregues të përmirësohet.

4.2. Performanca Financiare – Kostot e Shërbimit

4.2.1. Kostot e Shërbimit të Grumbullimit

Kostot e shërbimit i referohen kostos së shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe shërbimeve tjera si pastrimi i hapësirave publike. Kostot e shërbimit janë të prezantuara si të ndara për shërbimin e grumbullimit dhe transferit të mbeturinave si dhe kostos së gjithëmbarshme të menaxhimit të mbeturinave të ngurta. Struktura e përlllogaritje së kostos ndahet në kostot direkte të pajisjeve, stafit dhe materialit harxhues si dhe shpenzimeve të përgjithshme dhe indirekte. Në vijim janë të prezantuara kostot e shërbimit për secilin zëveq e veq.

4.2.2. Kostot e Pajisjeve

Në tabelën në vijim janë të kalkuluara kostot kapitale për pajisjet e grumbullimit të mbeturinave që përfshijnë kamionët dhe kontejnerët. Kostot historike janë nxjerrun nga kontabiliteti ndërsa norma e amortizimit vjetorë është llogaritur si herësi në mes kostos historike dhe jetëgjatësisë së pajisjes. Vlera e mbetur e pajisjes paraqet mbetjen në mes kostos historike të përvetësimit dhe zhvlerësimit të akumuluar. Jetëgjatësia për kamionë është marrë 7 vite ndërsa për kontejnerë ajo është adoptuar 3 vite.

4.2.3. Kostoja e Stafit

Kostot e stafit përfshijnë kostot e stafit të angazhuar direkt në grumbullimin dhe transferin e mbeturinave. Në këtë kategori përfshihen pagat, kontributet sociale dhe përfitimet tjera eventuale për mbikëqyrësit, vozitësit dhe personelin tjetër të angazhuar në ofrimin e shërbimit. Stafi tjetër i cili mbështet këtë shërbim është dhënë tek shpenzimet indirekte.

4.2.4. Kostot e Materialit Harxhues

NPK Higjiena ishte në gjendje të sigurojë të dhënat në lidhje me inputet operative për çdo lloj automjeti. Sistemi i monitorimit të brendshëm gjeneron të dhëna për konsumin specifik të naftës (l/100 km) vajit të motorit (l/1,000 km), vajit hidraulik (l/1,000 km), gomave (njësi/10,000 km) dhe baterive (njësi/20.000 km). Çmimet njësi për produktet standarde operative të siguruar në tregun vendor, janë dhënë për të llogaritur kostot direkte vjetore të materialeve harxhuese për grumbullimin e mbeturinave.

4.2.5. Përmbledhja e Kostove Direkte të Grumbullimit dhe Transferit

Tabela e mëposhtme i ka të përmbledhura kostot direkte të shërbimit të grumbullimit dhe transferit të mbeturinave. Këto kosto përfshijnë kostot direkte të stafit të angazhuar, kostot e amortizimit të pajisjeve dhe kostot e materialit harxhues. Kostoja direkte njësi për grumbullimin dhe transferin e mbeturinave është 16.1 Euro/ton.

Në tabelat në vijim janë të dhëna kostot e pajisjeve, kosto e stafit, kosto e materialit harxhues si dhe kostot e përmbledhura të grumbullit dhe transferit të mbeturinave:

Tabela Nr. 16: Performanca e kamionëve

	Kamioni Nr. 1	Kamioni Nr. 2	Kamioni Nr. 3	Kamioni Nr. 4	Kamioni Nr. 5	Total/Mesatarja
Brendi	Iveco	MAN	IVECO	Eskavator	Traktor	-
Targat	03-681-AR	03-469-CO	229-KS-517	-	-	-
Viti i Prodhimit	2001	1990	1999	1999	2000	-
Vjetersia	16 vjet	27 vjet	18 vjet	18 vjet	17 vjet	20.3 vjet
Kosto e Blerjes	Donacion	Donacion	Donacion	NA	NA	0.0 €
Vlera kontabel	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Tipi	Kompaktorë	Ngarkues	Kompaktorë	Eskavator	Traktor	-
Kapaciteti ne ton	4.5t	4.7t	12t	-	-	0.0 t
Mbeturinat e Grumbulluara	NA	NA	NA	-	-	3,380 t
Xhiro	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Kilometrazhi	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Konsumi i naftes ne litra	17,082 l	6,000 l	0.0 l	NA	NA	23,082 l
Oret e operimit	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Ngarkesa mesatare per xhiro	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Efikasiteti i Shfrytezimit	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Gjatesia mesatare e xhiros	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Koha mesatare e xhiros	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Konsumi i naftes l/100km	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Konsumi i naftes l/ton	NA	NA	NA	NA	NA	6.8 l/t

4.3. Kosto totale e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave

4.3.1. Kostoja e Infrastrukturës

Kostoja e infrastrukturës përfshin pajisjet për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transferit dhe deponimit të mbeturinave si dhe shërbimet sekondare. NPK "Higjiena" sa i përket aseteve të sajë nuk ka qenë në gjendje të ofrojë të dhëna mbi asetet e saja si kamionët, kontejnerët shumicën e të cilave i ka marrë përmes donacioneve. Meqë këto asete edhe ashtu e kanë kaluar jetën e dobishme prandaj edhe kosto e amortizimit të tyre mundë të merret e barasvlershme me zero.

Tabela Nr. 17: Kostot e pajisjeve për menaxhimin e mbeturinave

Specifikacionet e mjeteve		Copë	Kapaciteti		% e MMN	Viti i blerjes	Çmimi i blerjes në €	Vlera aktuale (e kontabilitetit) në €	Jetëgjatësia e mbetur (vite)	Kostoja vjetore e zhvleresimit
			m³	ton						
Mbledhja e mbeturinave	Iveco	1			100%	2001	0 €	0 €	0	0 €
	Iveco	1			100%	1990	0 €	0 €	0	0 €
	Man	1			100%	1999	0 €	0 €	0	0 €
	Traktor	1			100%	1999	0 €	0 €	0	0 €
	Eskavator	1			100%	2000	0 €	0 €	0	0 €
	Kontejnere 120 l	-			100%	-	-	0 €	0	0 €
	Kontejnere 1.1 m3	35			100%	-	-	0 €	0	0 €
	Kontejnere 7.1 m3	-			100%	0	-	0 €	0	0 €
Nentotali Mbledhja e Mbeturinave							0 €	0 €		0 €
Shpenzimet Totale per Mjete							0 €	0 €		0 €

4.3.2. Kostoja e Stafit Direkt

Kostoja e Stafit Direkt i atribuohet stafit të angazhuar drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve dmth stafit operativ i cili mundë ti alokohet kosto qendrave si grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave. Stafi i angazhuar në pastrimin e rrugëve dhe shërbimeve tjera komunale poashtu është i përfshirë si staf direkt.

Tabela Nr. 18: Shpenzimet e stafit për menagjimin e mbeturinave

Zona e shërbimit dhe pozita e stafit		Nr.	Rroga bazë €/muaj	Benificionet sociale €/muaj	Gjithsej kostoja direkte për staf për vitin		
					€/muaj	muaj/vit	€/vit
Mbledhja	Mbikqyres	1	300 €	50 €	350 €	12	4,200 €
	Vozites	4	250 €	50 €	300 €	12	14,400 €
	Punetore	6	190 €	50 €	240 €	12	17,280 €
	Nentotali Mbledhja e Mbeturinave	11					35,880 €
Total Kosto Direkte e Stafit		11					35,880 €

4.3.3. Kostoja e Materialit Harxhues

Kostoja totale e materialit harxhues është dhënë sa vijon për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Tabela në vijim i ka të përmbledhura kostot e materialit harxhues për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave:

Tabela Nr. 19: Kostot e materialit harxhues për menaxhimin e mbeturinave

Lloji i Materialit		Sasia e Shpenzuar	Kosto njesi €/njesi	Kosto
Grumbullimi	Nafta	17,082 l	1.1 €/l	18,449 €
	Vaji motorrik	361 l	3.0 €/l	1,083 €
	Vaji hidraulik	-	-	- €

Goma	-	-	3,629 €
Akumulate	0	0.0 €/cope	- €
Kostot e regjistrimit	1	440 €/cope	440 €
Total Grumbullimi	-	-	23,601 €

4.3.4. Kostot e deponimit

Kosto e deponimit është kosto e zbatuar nga KRM Ambijenti për mbeturinat e deponuara nga NPK Higjiena.

Tabela Nr. 20: Kostot e deponimit të mbeturinave

Mbeturinat e deponuara	Tarifa e KRM Ambijenti	Kosto e deponimit
3,380 t	3.0 €/t	10,140 €

4.3.5. Kostoja e Stafit Indirekt

Kostoja e stafit indirekt i referohet personelit i cili është i përfshirë vetëm në mënyrë indirekte në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, por i cili gjeneron kosto të cilat duhet të alokohen proporcionalisht sipas kontributit të angazhimit tek qendrat e kostove të grumbullimit, transferimit, deponimit dhe shërbimeve tjera sekondare.

Në mënyrë që të vlerësohet kostoja totale vjetore e stafit indirekt, janë marrë si bazë pagat themelore dhe përfitimet sociale të paguara në baza mujore për poste të ndryshme.

Tabela Nr. 21: Kostot e stafit indirekt për menaxhimin e mbeturinave

Zona e shërbimit dhe posti i stafit		Nr.	Rroga bazë €/muaj	Mëditjet €/muaj	Gjithsej kostoja direkte për staf		
					€/muaj	muaj/vitt	€/vit
Administrata	KE	1	580 €	50 €	630 €	12	10,809 €
	Inkasantet	2	250 €	50 €	300 €	12	7,629 €
	inspektore	1	250 €	50 €	300 €	12	8,769 €
	Faturist dhe arkatar	1	450 €	50 €	500 €	12	8,769 €
	Të tjere	1	175 €	50 €	225 €	12	5,229 €
	Nentotali Stafi i Menaxhmentit dhe admini.	6					27,600 €
Total i Shpenzimeve Indirekte per Staf		6					27,060 €

4.3.6. Kostoja tjera indirekte dhe administrative

Tabela Nr. 22: Kostoja e stafit indirekt

Tipi i Shpenzimit	Kosto totale	Pjesemarrja në MM	Kosto Administrative dhe Indirekte
	€/vit	%	€/vit
Tatimi ne fitim	- €	100.0%	- €
Tatimi ne prone	- €	100.0%	- €
Sigurimi	- €	100.0%	- €
Pagimi i licencave	- €	100.0%	- €
Komunalite	- €	100.0%	- €
Pajisjet e zyres	- €	100.0%	- €
Kompjutere dhe printere	300 €	100.0%	300 €
Communication costs	- €	100.0%	- €

Kosto te trajnimit	- €	100.0%	- €
Kosto te qerese	- €	100.0%	- €
Kosto te transportit	- €	100.0%	- €
Material harxhues	6,675 €	100.0%	6,675 €
Kosto tjera administrative	- €	100.0%	- €
Kosto totale administrative dhe indirekte	6,975 €	-	6,975 €

4.3.7. Përmledhje e Kostos Totale të Shërbimit

Kostoja totale e shërbimit është dhënë në tabelën e mëposhtme. Kostoja totale e shërbimit për KRM Higjiena është 103,656 Euro. Ngarkesa mujore për amvisëri nga përlogaritja për gjithë zonën e shërbimit është 5.15 €/muaj.

Tabela Nr. 23: Kostot totale të menaxhimit të mbeturinave

Lloji i koston	Kosto e KRM "Higjiena"	Pjesëmarrja në MM	Kosto e MM 2017
Kosto e stafit direkt	35,880 €	100%	35,880 €
Kosto e materialit direkt	23,601 €	100%	23,601 €
Kosto e deponimit	10,140 €	100%	10,140 €
Kosto kapitale	- €	100%	- €
Kosto e stafit administrativ	27,060 €	100%	27,060 €
Kosto indirekte dhe administrative	6,975 €	100%	6,975 €
Total Kosto:	103,656 €	100%	103,656 €
Numri i amvisërive të shërbyera	1,677		
Kosto mujore për amvisëri	5.15 €/muaj		

4.4. Performanca Financiare – Të hyrat dhe mbulimi i koston

4.4.1. Të hyrat operative dhe arkëtimi

Të hyrat operative në NPK Higjiena për vitin 2017 kanë qenë 122,465 € ndërsa i ka arkëtuar në lidhje me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave ajo i ka grumbulluar 114,191 € apo 93.2% të mjeteve financiare. Vlen të theksohet fakti se të hyrat e arkëtuara janë të nivelit mbi 100% për shkak të shlyerjes së obligimeve ndaj NPK Higjiena nga ana e komunës dhe institucioneve tjera ndërsa shkalla relativisht e lartë arkëtimit për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave i referohet në masë të konsiderueshme programit qeveritar për shlyerjen e borxheve të vjetra.

Në tabelat në vijim (Nr.24 dhe 25) janë prezantuar të dhënat në lidhje me të hyrat nga faturimi si dhe mjeteve financiare të arkëtuara.

	Kategoritë e të hyrave	Të Hyrat 2017
1	Të hyrat nga amvisërit	55,264 €
2	Të hyrat nga biznesi - faturimi me tarifa	33,876 €
3	Të hyrat nga institucionet	33,325 €
4	Të hyrat nga grumbullimi i mbeturinave	122,465 €

5	Të hyrat tj. Operative	-
6	Të hyrat nga Donacionet dhe Grantet	-
7	Gjithsejt të hyrat	122,465€

1	Kategorit e klientëve	Arkëtimi për 2017 në € dhe %
2	Amvisëritë €	44,628 €
3	Amvisëritë %	80.8 %
6	Biznesi €	27,739 €
7	Biznesi %	81.9 %
8	Institucionet	41,824 €
9	Institucionet €	125.5 %
10	Te hyrat nga veprimtaria sekondare €	- €
11	Te hyrat nga veprimtaria sekondare %	- %
12	Inkasimi nga Grumbullimi i Mbeturinave €	114,191 €
13	Inkasimi nga Grumbullimi i Mbeturinave %	93.2%
14	Gjithësejinkasimi	114,191 €

4.4.2. Tarifat dhe mbulimi i kostos

Komunat janë të obliguara që sipas Ligjit mbi Mbeturinat të përcaktojnë tarifat për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të ngurta komunale. Pavarësisht kësaj kërkesë ligjore komuna e Deçanit ende nuk i ka përcaktuar tarifat e reja të shërbimit.

Momentalisht në zbatim janë tarifat e vitit 2006 të përcaktuara nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZrrUM) me disa ndryshime që janë adoptuar në ndërkohë. Këto tarifa i kanë tri kategori kryesore, dmth. Amvisëritë, bizneset dhe institucionet të cilat ndahen në nënkategori tjera.

Tabela Nr. 26: Tarifat në fuqi për NKP Higjiena:

Kategoria	€/muaj	€/banore/ muaj	€/m2	€/zbrazje
Amvisëritë	3.26 €			
Dere me dere	3.26 €	-	-	-
Me kontejnere të përbashkët	3.26 €	-	-	-
Bizneset	-	-	-	-
Dyqane të vogla	4.4 €	-	-	-
Dyqane të mesme	5.6 €	-	-	-
Qebaptore	12.0 €	-	-	-
Pompa	15.0 €	-	-	-
Restorane	21.5 €	-	-	-
Biznese të mëdha	150.0 €	-	-	-
Thertore	300.0 €	-	-	-
tjere	- €	-	-	-
Institucionet		-	-	
Shkollat fillore	8.1 €	-	-	5.5 €
Shkollat e mesme	8.1 €	-	-	5.5 €
Universitetet	- €	-	-	5.5 €

Ambulantat	8.1 €	-	-	5.5 €
Spitalet	- €	-	-	5.5 €
Klinika Private	- €	-	-	5.5 €
Policia	- €	-	-	5.5 €
Gjykata	60.5 €	-	-	5.5 €
Komuna	- €	-	-	5.5 €
tjera	- €	-	-	5.5 €

Tabela Nr. 27: Të hyrat, kostot dhe arkëtimi për NPK Higjiena për vitin 2015:

1	Te Hyrat nga Grumbullimi i Mbeturinave ⁵	122,465 €
2	Keshi i Arketuar nga Grumbullimi i Mbeturinave	114,191 €
3	Te hyrat nga Sherbimet Sekondare	- €
4	Keshi i Arketuar nga Sherbimet Sekondare	- €
5	Te hyrat Totale nga Sherbimi i Mbeturinave	122,465 €
6	Arketimi Total nga Sherbimi i Mbeturinave	114,191 €
7	Kostot nga Grumbullimi i Mbeturinave	103,656 €
8	Kostot Totale të Shërbimit të Mbeturinave	103,656 €

Nga tabela e mësipërme e të hyrave dhe kostove të shërbimit del se NPK Higjiena është subjekt pjesërisht i vetëmbajshëm i cili përmes të hyrave të cilat i gjeneron dhe inkason është në gjendje ti mbuloj kostot operative të shërbimit ndërsa kërkon mbështetje në pjesën e investimeve kapitale sidomos kur kihet parasysh infrastruktura e stërvjetruar si dhe nevojave të ngritjes së kapaciteteve operative për të ofruar shërbimin në tërë kufijtë administrativ të komunës së Deçanit.

4.5. SWOT analiza

Përparësitë	Mangësitë
- Komuna e interesuar për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave - Komuna e mbështet me buxhet kompaninë - Komuna ka avancuar me reforma institucionale - Komuna ka ndërtuar kapacitete të konsiderueshme menagjuese nga lëmi i MM - Interesimi i qytetarëve për t'u integruar në skemën e menaxhimit të mbeturinave, përkatësisht grumbullimin e mbeturinave	- Shkallë e ulët e mbulimit me shërbim - Kompania ka probleme serioze financiare dhe a paaftë të investoj në makineri për MM - Organizimi joadekuat i grumbullimit të mbeturinave. - Mbeturinat hedhen në deponitë e egra në qytet dhe zonat përreth - Numri i pamjaftueshëm i kontejnerëve - Shumica e mekanizimit është e vjetra dhe e amortizuar - Nuk ka aktivitete të organizuara për ndarjen dhe / ose riciklimin - Mbeturinat shtazore mblidhen dhe hidhen së bashku me mbeturinat komunale - Një pjesë e mbeturinave medicinale derdhen në kontejnerë komunal prej 1.1m³ - Nuk ka deponim të veçantë për mbeturinat ndërtimore dhe të vëllimshme - Nuk ka informacion të saktë për sasinë e mbeturinave të krijuara

⁵Këtu janë të përfshirë kostot e grumbullimit, transferit dhe deponimit të mbeturinave por jo edhe shpenzimet administrative

	• Numri i madh i deponive ilegale (31) • Komuna nuk organizon aktivitete për ngritjen e vetëdijes publike për menaxhimin e mbeturinave
Mundësitë	Rreziqet
• Qasje në fonde për MM nga organizatat ndërkombëtare • Dispozitat ligjore mundësojnë që komuna të marr përgjegjësi shtesë për menaxhim të mbeturinave, pshinkasimi • Planet nacionale për menaxhim të mbeturinave kërkojnë zvogëlim të sasisë së mbeturinave që shkojnë në deponi. • Mundësi që përmes zgjerimit të shërbimit të optimizohen kostot dhe maksimizohen të hyrat • Mundësi për zhvillimin e biznesit të riciklimit dhe tregëtimit me material të riciklueshëm • Përmirësim në mjedisin jetësor dhe ambientin	• Interpretimet e ndryshme ligjore rreth përgjegjesive të komunës për menaxhim të mbeturinave • Mungesa e mekanizmave adekuat për rritjen e inkasimit të tarifës për grumbullim, transportim dhe deponim të mbeturinave • Qështja e pazgjidhur e mbeturinave shtazore në nivel nacional • Mbeturinat në deponitë ilegale, sidomos ato me mbetje shtazore, afër zonave të banimit, rrezikojnë shëndetin e banorëve • Ndotja e lumenjëve rrezikon vendbanimet nga vërshimet • Vurrja e zjarrit mbeturinave bënë ndotjen e ajrit dhe kanosje për zgjerim të zjarrit.

4.6. Sfidat e menaxhimit të mbeturinave

Komuna e Deçanit ka sfida mjaft të mëdha në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Analiza e gjendjes ekzistuese vë në pah disa prej tyre:

- Mbulimi i ulët me shërbime të grumbullimit të mbeturinave, vetëm 27% të popullatës kanë qasje në shërbime. Mbulimi i ulët me shërbime i atribuohet kapacitetve të mangëta të NPK "Higjiena" që të ofrojë shërbime për të gjithë qytetarët e saj. NPK "Higjiena" posedon makineri të vjetruar dhe infrastrukturë të amortizuar. Në të njëjtën kohë, kualiteti i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nuk është në nivelin e duhur. Për komunën e Deçanit do të jetë sfida serioze që të adresojë çështjen e ofrimit të shërbimeve për grumbullim të mbeturinave dhe ngritjen e kualitetit të shërbimeve duke marrë parasysh mangësitë e sipërpërmendura dhe kapacitetin financiar të komunës.
- Zgjerimi i shërbimit në tërë zonën e shërbimit nga niveli ekzistues (27%) është sfida serioze për NPK "Higjiena" qoftë në sigurimin e infrastrukturës po ashtu edhe kapaciteteve organizative që të ofroj shërbim cilësor.
- Zgjerimi i shërbimit nënkupton edhe gatishmërinë e qytetarëve të bëhen pjesë e skemës qoftë përmes pagesës së rregullt të tarifës apo sigurimit të kontejnerëve individual aty ku zbatohet shërbimi derë më derë. Mosgatishmëria e qytetarëve mundë ti sfidoj objektivat e zgjerimit të vendosura nga komuna.
- Inicimi i aktiviteteve për ndarje të mbeturinave është sfida në vete duke marrë parasysh problemet bazike me grumbullim të mbeturinave dhe deponitë ilegale përgjatë gjithë komunës.
- Disa probleme serioze që shfaqen në MM kanë të bëjnë në fushat ku komuna nuk ka kompetenca të plota si mbeturinat medicinale (Ministria e Shëndetësisë) apo mbeturinat shtazore (mungesa e impiantit për procesimin e mbeturinave shtazore në nivel të

Kosovës). Mosbashkëpunimi i palëve të jashtme apo mosekzistimi i infrastrukturës adekuate mundë të sfidojë vendosjen e një sistemi të MM në komunë përgjatë periudhës planifikuese.

5. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

5.1. Vizioni

Vizioni është mjet nëpërmes të cilit komuna përcakton kahjet e menaxhimit të mbeturinave në një periudhë më të gjatë kohore. Si i tillë, vizioni fokusohet në gjendjen në të cilën dëshiron të shohë sektorin e menaxhimit të mbeturinave pas një kohe të caktuar. Vizioni del si rezultat i analizës së gjendjes ekzistuese, përfshi edhe kapacitet ekzistuese të komunës për udhëhequr reformat në këtë sektor. Duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese dhe përmbajtjen e SWOT analizës, vizioni i komunës së Deçanit synon si në vijim:

Deçani i pastër, me cdo vendbanim të shërbyer dhe sistem të mirëfilltë të ndarjes së mbeturinave, kontribon në mbrojtje të mjedisit dhe promovon zhvillimin ekonomik lokal.

Komuna e Deçanit synon që të ofrojë shërbime të grumbullimit të mbeturinave të gjithë qytetarëve të saj. Në të njejtën kohë, komuna synon që të krijojë sistem të mirëfilltë të ndarjes së mbeturinave për të zvogëluar sasinë e mbeturinave që shkojnë në deponi dhe rrjedhimisht të zvogëlojë ndikimin negativ në mjedis.

Sistemi i ndarjes do të fillojë gradualisht nga ekonomitë familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese. Më tutje komuna synon që gjatë këtij procesi të edukojë qytetarët rreth benefiteve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenjes për qytetarë.

5.2. Objektivat e nivelit qendror

Strategjia dhe Plani për Menaxhim të Mbeturinave (MMPH)

Objektivat e komunës së Deçanit përveç që adresojnë problemet edhe gjendjen ekzistuese në komunë, ato adresojnë edhe objektivat e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhim të Mbeturinave 2013-2022 si dhe aktivitetet që dalin nga Plani Kombëtar për Menaxhim të Mbeturinave.

Strategjia për Menaxhim të Mbeturinave 2013 – 2022 përcakton objektivat si në tabelën në vijim:

Tabela Nr. 28: Objektivat për realizimin e qëllimeve e strategjisë⁶

Qëllimet	Përqindja %/vit			
	2013	2015	2019	2022
Grumbullimi i mbeturinave komunale	50	70	80	90
Ndarja në lloje e mbeturinave komunale	0	20	30	50
Trajtimi i mbeturinave	10	20	35	40
Sasia e mbeturinave të hedhura në deponi	90	80	65	60
Sasia e mbeturinave biodegraduese	95	85	70	40

Niveli qendror, nëpërmes strategjisë ka përcaktuar si objektiv që deri me 2022 grumbullimi i mbeturinave komunale në të gjitha komunat e Kosovës të mbijë në shkallën prej 90%. Sa i përket ndarjes së mbeturinave, strategjia kërkon që deri me 2022 shkalla e ndarjes së mbeturinave të mbërrijë deri në 50%, ndërsa trajtimi i tyre të mbërrijë deri në 40%. Në të njejtën kohë, strategjia kërkon që sasia e mbeturinave që hedhen në deponi të zvogëlohen deri në 60%, ndërsa që sasia e mbeturinave biodegraduese që hedhen në mbeturina komunale deri në vitin 2022 të zvogëlohet deri në 40%.

⁶ burimi: Strategjia për Menaxhim të Mbeturinave 2013 – 2022

Tabela Nr. 29: Objektivat e strategjisë për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave të veçanta⁷

Mbeturina	Afati i fundit	Proporcioni (% masore)	
		Ripërdorim	Riciklim
Mbeturinat e ambalazhit	2018 - 2022	40 – 65	40 – 55
Automjetet mbeturinë	2018 - 2021	60 – 70	90 – 95
Mbeturinat elektrike dhe elektronike	2018 – 2021	70 – 80	80 – 90
Mbeturinat e gomës	2018 – 2022	30 – 70	20 – 30
Vajrat mbeturinë	2018 - 2022	40 - 60	-

Strategjia gjithashtu ka përcaktuar objektivat për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave të veçanta. Deri në vitin 2022 mbeturinat e ambalazhit duhet të futen në ripërdorim në masë prej 65% dhe në riciklim në masë prej 55%. Mbetjet elektrike dhe elektronike duhet të arrijnë shkallën e ripërdorimit deri në 80% dhe të riciklimit deri në 90%. Ndërsa mbeturinat e gomave të përdorura do të duhej të ripërdoren deri në shkallë prej 70% ndërsa riciklim deri në 30%.

PKMM duhet të udhëzojë komunën e Deçanit si të përbushë kërkesat e sipërpërmendura të Strategjisë dhe Planit dhe të përcaktojë objektivat e komunës dhe strategjitë për zbatim duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese, kapacitetet investive dhe teknike të komunës.

5.3. Objektivat e PKMM Deçan

Objektivat janë strukturuar duke marrë parasysh temat të cilat janë analizuar në pjesën e gjendjes ekzistuese dhe me anë të të cilave synohet që të arrihet vizioni i përcaktuar me plan. Në të njëjtën kohë objektivat e PKMM-së reflektojnë në gjendjen ekzistuese dhe problemet në sektor.

Qëllimi 1: Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit të grumbullimit të mbeturinave

- O1: Riorganizimi i zonave për shërbime të grumbullimit të mbeturinave me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimit në pesë vitet e ardhshme.
- O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë territorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.
- O3: Optimizimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave.

Qëllimi 2: Inicimi i procesit për ndarje të mbeturinave në burim duke synuar që të zvogëlohet sasia e mbeturinave që përfundojnë në deponi.

- O4: Ndarja e mbeturinave në burim në shkollat publike dhe institucionet publike komunën e Deçanit, deri në fund të vitit 2021.
- O5: Inicimi i ndarjes së mbeturinave në burim në amvisëri, në dy fraksione (të riciklueshme dhe të pa riciklueshme), deri në fund të vitit 2021.
- O6: Ndarja e mbeturinave në hapësira publike nëpërmes ishujve ekologjik, në 2 lokacione deri në fund të viti 2021.
- O7: Menaxhimi qëndrueshëm i mbeturinave të vëllimshme.
- O8: Krijimi i sistemit lokal të kompostimit.

⁷ Burimi: burimi: Strategjia për Menaxhim të Mbeturinave 2013 – 2022

Qëllimi 3: Grumbullimi, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogëlimit të sasisë që përfundon në deponi.

O9: Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave shtazore.

O10: Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave medicinale.

O11: Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave ndërtimore.

Qëllimi 4: Reformat administrative

O12: Reformat administrative

O12.1 Themelimi i njesisë së menaxhimit për mbeturina

O12.2 Miratimi i rregullave për menaxhim të mbeturinave

O13: Përcaktimi i tarifës për grumbullim, transportim dhe deponim të mbeturinave

Qëllimi 5: Vetëdijësimi

O13: Krijimi i kampanjës për vetëdijësim dhe informim rreth efekteve pozitive dhe negative të mbeturinave, rreth orarit dhe rregullave të grumbullimit dhe hedhjes së mbeturinave.

Në vijim secili nga objektivet është i shtjelluar dhe elaboruara në veqanti:


5.3.1. Qëllimi 1: Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit të mbeturinave

5.3.1.1 O1: Riorganizimi i zonave për shërbime të grumbullimit të mbeturinave me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimit në pesë vitet e ardhshme.

Objekti i parë dhe një ndër më të rëndësishmit është riorganizimi i zonave për shërbim. Riorganizimi i zonave për shërbim të grumbullimit të mbeturinave do t'i paraprijë rritjes graduale të mbulueshmërisë me shërbime. Nëse nuk kemi riorganizim efikas të zonave për shërbime, atëherë as rritja graduale e shërbimeve nuk mund të zbatohet si duhet. Riorganizimi nënkupton analizë të rrjetit të rrugëve dhe shpërndarjes hapësimore. Në të njëjtën kohë, riorganizimi do të merr parasysh edhe numrin e vendbanimeve, sasinë e mbeturinave për çdo vendbanim dhe ditët e shërbimit.

Ashtu siç është paraqitur në gjendjen ekzistuese, në komunën e Deçanit aktualisht nuk shërbehen 19 fshatra. Riorganizimi nënkupton futjen në sistem të shërbimit edhe të këtyre fshatrave të cilat nuk shërbehen.

Figura Nr. 5: Koncepti për zgjerim të shërbimeve




Koncepti i ndarjes së komunës së Deçanit në zona të shërbimit fillon nga qyteti. Qyteti konsiderohet si pikë qendrore ku ofrohet shërbim i kombinuar – një ditë në javë për shtëpi individuale të shërbyer me kontenjerë 120 lit dhe shtatë ditë në javë për objektet shumëbanesore të shërbyer me kontenjerë 1.1m³.

Si i tillë, qyteti qendron si zonë e ndarë e shërbimit nga fshatrat. Nga qyteti pason ndarja e komunës në zona tjera të shërbimit. Ndarja e fshatrave në zona bazohet në rrjetin rrugor aktual, në ditët e punës për shërbim, sasinë e

mbeturinave të gjeneruara për zonë, dhe përgjegjësitë e ndara për zonë. Me përgjegjësi nënkuptohet që çdo zonë parimisht të ketë makinerinë e ndarë që do ta shërbente atë zonë. Në këtë mënyrë, komuna do të ketë më të lehtë të shërbejë zonat sipas ditëve të javës, futjen e operatorëve tjerë në shërbim – nëse paraqitet nevoja - dhe monitorimin e punës së operatorëve që e kryejnë shërbimin.

Harta Nr. 11: Zonat e shërbimit për grumbullimi të mbeturinave në komunën e Deçanit



Duke u bazuar në konceptin e sipërpërmendur, komuna e Deçanit do të ndahet në 5 zona të përgjithshme të shërbimit përfshi edhe qytetin si zonë e veçantë. Zonat janë të ndara si në vijim:

- **Zona 1, e hënë:** Qyteti dhe fshatrat Carrabreg i Ulët dhe i Epërm. Qyteti do të shërbehet një herë në javë për amvisëritë në shtëpi individuale (120 lit) dhe shtatë herë në javë për amvisëritë që banojnë në objekte shumëbanesore (1.1m³). Fshatrat Carrabreg i Ulët dhe i Epërm do të shërbehen një herë në javë;
- **Zona 2, e martë:** Fshatrat Hulaj, Pobergjë, Voksh, Lloqan, Sllup, Drenoc, Prilep, Rastavicë, dhe Baballoq do të shërbehen një herë në javë;
- **Zona 3, e mërkurë:** Fshatrat Vranoc i vogël, Maznik, Dashinoc, Pozhar, Kodrali, Ratishë i Ulët dhe i Epërm, Irznik, Prelluk, Glllogjan, Shaptej, Dubravë, dhe Gramaqel do të shërbehen një herë në javë;
- **Zona 4, e enjte:** Fshatrat Isniq, Belle, Dubovik, Prapaqan, Papiq, Lumbardh, Llluka e Ulët dhe e Epërme, dhe Belek do të shërbehen një herë në javë.
- **Zona 5, e premte:** Strellc i Epërm dhe i Ulët, dhe Lëbushë do të shërbehen një herë në javë.

5.3.1.2 O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime për të gjitha amvisëritë, institucionet dhe bizneset në komunën e Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri 31 Dhjetor 2019.

Komuna synon që deri në fund të vitit 2019 të mbulojë të gjitha amvisëritë, institucionet dhe bizneset me shërbime të grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave. Rritja graduale nënkupton zgjerim të shërbimeve në dy faza:

1. Zgjerimi fillestar do të ofrohet tek fshtatrat të cilat kanë qasje në shërbim mirëpo nuk janë të mbuluar 100%. Kjo synohet të arrihet deri në fund të vitit 2018.
2. Pjesa e dytë e zgjerimit do të fokusohet në fshatrat të cilat kanë zero qasje në shërbim. Zgjerimi në këto fshatra synohet të arrihet deri në fund të vitit 2019.

Tabela Nr. 30: Rritja e mbulueshmërisë së shërbimit deri në fund të vitit 2018

		Numri i Amviserive	Amviserite e shërbyera 2018	Mbulimi aktual me shërbim	Amvisëritë për tu futë në shërbim deri në fund të 2018	Amvisëritë për tu futë në shërbim %	Mbulimi me shërbim më 31 Dhjetor 2018
Nr.	Vendbanimet	3,178	1677	45.10%	2,041	54.9%	
1	Beleg	131	95	72.50%	36	27.5%	100%
2	Carrabreg i Epërm	207	161	77.90%	46	22.2%	100%
3	Carrabreg i Ulët	304	188	61.80%	116	38.2%	100%
4	Deçan	607	487	80.20%	120	19.8%	100%
5	Drenoc	170	135	79.20%	35	20.6%	100%
6	Hulaj	31	20	64.00%	11	35.5%	100%
7	Irzniq	243	2	0.80%	241	99.2%	100%
8	Isnq	583	17	2.90%	566	97.1%	100%
9	Lëbushë	170	32	18.80%	138	81.2%	100%
10	Lloqan	92	77	83.90%	15	16.3%	100%
11	Llukë e Epërme	191	118	61.90%	73	38.2%	100%
12	Pobërxhë	194	123	63.50%	71	36.6%	100%
13	Pozhar	66	8	12.20%	58	87.9%	100%
14	Ratish i Epërm	34	31	90.40%	3	8.8%	100%
15	Ratish i Ulët	58	51	87.20%	7	12.1%	100%
16	Sllup	44	41	92.40%	3	6.8%	100%
17	Strellc i Epërm	510	14	2.70%	496	97.3%	100%
18	Voksh	83	77	93.10%	6	7.2%	100%

Nga totali i 3,178 amvisërive në 18 fshatra, momentalisht vetëm 1,677 amvisëri apo 45% janë të shërbyera. Pjesa tjetër e amvisërive të cilat nuk shërbehen janë 2,041 amvisëri apo 55%. Ky numër i amviserive të pa shërbyera do të futën 100% në shërbim deri në fund të vitit 2018.

Tabela Nr. 31: Rritja e mbulueshmërisë së shërbimit deri në fund të vitit 2019

		Numri i Amviserive	Amviserite e shërbyera aktualisht	Mbulimi me shërbim	Amvisëritë për tu futë në shërbim 1 Janar - 31 Dhjetor 2019	Mbulimi me shërbim më 31 Dhjetor 2019
Nr.	Vendbanimet	2,214	0	0.0%	2,214	100%
1	Baballog	257	0	0.0%	257	100%
2	Belle	2	0	0.0%	2	100%
3	Dashinoc	42	0	0.0%	42	100%
4	Dubovik	142	0	0.0%	142	100%
5	Dubravë	43	0	0.0%	43	100%
6	Glllogjan	140	0	0.0%	140	100%
7	Gramaçel	161	0	0.0%	161	100%
8	Kodralli	137	0	0.0%	137	100%
9	Lumbardh	116	0	0.0%	116	100%
10	Llukë e Ulët	75	0	0.0%	75	100%
11	Maznik	61	0	0.0%	61	100%
12	Papiq	25	0	0.0%	25	100%
13	Prapaqan	110	0	0.0%	110	100%
14	Prekolluk	46	0	0.0%	46	100%
15	Prilep	295	0	0.0%	295	100%
16	Rastavicë	161	0	0.0%	161	100%
17	Strellc i Ulët	307	0	0.0%	307	100%
18	Shaptej	81	0	0.0%	81	100%
19	Vranoc i Vogël	13	0	0.0%	13	100%

Momentalisht në 19 fshatra, për 2,214 amvisëri nuk ofrohet fare shërbim i grumbullimit të shërbimit. Deri në fund të vitit 2019 komuna do të fus në shërbim 100% të gjitha amvisëritë në këto fshatra, 2,214 në total.

Për të filluar me rritjen graduale të shërbimit duhet të kalohet nëpër tri hapa kryesore:

- Reforma administrative e kompanisë “Higjiena”
Në mënyrë që kompania të shfrytëzojë të gjitha kapacitetet e saja teknike dhe njerëzore nevojitet për një reformë të thellë administrative. Reforma nënkupton rishikim të pozitave të punës të të gjithë punëtorëve të kompanisë dhe sistematizim e ri të tyre.
- Fushata e informimit dhe e vetëdijësimit
Komuna do të informojë të gjithë qytetarët për shtrirje të shërbimit në vendbanimet e tyre. Në të njëjtën kohë do të fillojë më një fushatë të vetëdijësimit.
- Zbatimi i planit të zgjerimit
Komuna në bashkëpunim me kompaninë do të udhëheqë procesin e shtrirjes së shërbimit në të gjithë komunën deri në fund të vitit 2019.

Tabela Nr. 32: Rritja e mbulueshmërisë së shërbimit 2018 – 2019

Rritja e mbulueshmërisë së shërbimit 2018 - 2019	Numri i amvisërive të reja që futen në sistem	Numri i amvisërive të shërbyera	Shkalla e mbulimit %
Mbulueshmëria aktuale: 2017	-	1,677	28.0%
Rritja e mbulueshmërisë: 31 Dhjetor 2018	2,043	3,720	62.7%
Rritja e mbulueshmërisë: 31 Dhjetor 2019	2,215	5,935	100%

Deri në fund të vitit 2018 mbulueshmëria e shërbimit do të rritet për 34%, apo 2,043 amvisëri të reja do të futen në shërbim. Ndërsa, deri në fund të vitit 2019 mbulueshmëria do të rritet për 37%, apo 2,215 amvisëri të reja do të futen në shërbim për të përmbyllur ciklin e rritjes së shërbimeve në 100%.

5.3.1.3 O3: Optimizimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave.

Grumbullimi i mbeturinave do të vazhdojë të funksionojë me kontenjerat 120 / 140 lit, 1.1 m³, dhe me qese te plastikës. Mirëpo, plani ka rishikuar infrastrukturën e grumbullimit me të cilin vendbanimet do të shërbehën. Kjo nënkupton që disa vendbanime/zona do të shërbehën me një lloj të kontenjerëve, disa me një apo më shumë lloje të kontenjerëve, apo edhe me qese varësisht nga rrugët, shpërndarja hapësinore dhe konfiguracioni i terrenit në të cilin gjenden vendbanimet. Sistemi i grumbullimit të mbeturinave do të bëhet me infrastrukturën si në vijim:

- Shtëpitë individuale me kontejner 120l (në të gjithë zonën e shërbimit);
- Banimet kolektive me kontejner 1.1 m³;
- Bizneset në zonën rurale dhe periurbane me kontejner 120 l;
- Bizneset në zonën urbane me kontejner 1,1 m³;
- Bizneset e medha me kontejner te veçantë (rural & urban).

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave është i lidhur ngushtë me objektivin e dytë i cili i përckaton fazat e rritjes së mbulimit me shërbim. Futja në shërbim për të gjitha amvisëritë (shtëpitë individuale) do të bëhet edhe nëse komuna nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të blerë kontenjerat 120 l. Në rast se komuna nuk ka mjete te mjaftueshme për blerjen e kontenjerave grumbullimi i mbeturinave do të bëhet nëpërmes qeseve dhe mandej të fillojë të shpërndajë kontenjerat 120 l për çdo amvisëri.

Objektivi i dytë ka përcaktuar që deri në fund të vitit 2018 të futen në shërbim 2,043 amvisëri, dhe deri në fund të vitit 2019 të futen në shërbim 2,215 amvisëri. Para se të alokojë mjetet për blerjen e kontenjerëve 120 lit, komuna do të identifikojë numrin e saktë të amvisërive që banojnë në objekte kolektive që do të shërbehën me kontenjerë 1.1m³. Kjo llogaritje do të japë numrin e saktë të amvisërive që jetojnë në shtëpi individuale dhe të cilat do të duhet të shërbehën me kontenjerat 120 lit. Në këtë mënyrë komuna do të mund saktë të planifikojë buxhet për blerjen e kontenjerëve të nevojshëm për shërbim.

5.3.2. Qëllimi 2: Inicimi i procesit për ndarje të mbeturinave në burim duke synuar që të zvogëlohet sasia e mbeturinave që përfundojnë në deponi.

Ndarja e mbeturinave në burim në institucione është hapi i parë drejt ndarjes së mbeturinave në burim në të gjitha amvisëritë, dhe rrjedhimisht zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që shkon në deponi. Në të njëjtën kohë, vlenë të theksohet se ndarja e mbeturinave në burim është e kushtueshme dhe se në të gjitha rastet niveli lokal është ai që të duhet të subvencionojë këtë veprimtari. Përfitimi nga ky proces është zvogëlimi i mbeturinave që

shkon në deponi dhe zvogëlimi i ndikimit negativ në mjedis. Duhet të jetë e qartë që menaxhimi i mirëfilltë i mbeturinave bartë kosto financiare dhe asesi nuk duhet të krijohet iluzioni që mbeturinat janë aset i komunës. Kështu që, për ndarje dhe reciklim është komuna ajo e cila duhet të zotohet politikisht dhe financiarisht për të mbështetur këtë veprimtari.

Proces i ndarjes së mbeturinave në institucione publike shihet si parakusht për të filluar ndarjen në burim në amvisëri sepse mundëson që fëmijët në shkollë të mësojnë për pikat pozitive të ndarjes së mbeturinave dhe si ti ndajnë ato. Supozohet që këtë njohuri dhe mesazh fëmijët të përçojnë në familjet e tyre duke i inkurajuar që të fillojnë me ndarjen e mbeturinave në burim. Procesi i ndarjes në burim në institucione publike supozohet që do të inkurajoj punonjësitë e sektorit publik në mënyrë që të bartin këtë praktikë edhe në shtëpitë e tyre, dhe në të njëjtën kohë të testohet ky proces.

Ndarja në burim do të fillojë të aplikohet në shkolla dhe institucione publike sepse ndarja në këto institucione është me e lehtë dhe më pak e komplikuar në krahasim me ndarjen në burim në amvisëri. Në të njëjtën kohë ndarja dhe reciklimi i mbeturinave do të mundësojë arritjen e caceve të Strategjisë për Menaxhim të Mbeturinave 2015 – 2020 për të ulur sasinë e mbeturinave që shkojnë në deponi. Në të njëjtën kohë me ndarje në burim fitohen fraksione të pastërta të materialeve të riciklueshme të cilat mund të nxisin bizneset lokale për rishfrytëzim apo reciklim.

5.3.2.1 O4: Ndarja e mbeturinave në burim në shkollat publike dhe institucionet publike komunën e Deçanit, deri në fund të vitit 2022.

Procesi i ndarjes së mbeturinave do të organizohet në dy faza. Ndarja e mbeturinave fillimisht do të bëhet në dy fraksione: të riciklueshme dhe të pareciklueshme.

Faza e parë e ndarjes së mbeturinave në burim do të fillojë në vitin 2020 me shkollat dhe institucionet publike që gjenden në qytetin e Deçanit.

Faza e dytë e ndarjes së mbeturinave në burim do të fillojë në vitin 2021 me të gjitha shkollat dhe institucionet publike që gjenden jashtë qytetit të Deçanit, dmth në fshatra.

Tabela Nr. 33: Lista e institucioneve institucionet publike dhe viti i fillimit të ndarjes së mbeturinave

Nr.	Emrat e Institucioneve Publike	Vendi	Viti 2020	Viti 2021
1	Komuna	Deçan	√	
2	Policia	Deçan	√	
3	Zjarrefiksati	Deçan	√	
4	QRC – Qendra e regjistrimit civil	Deçan	√	
5	Zyra e gjendjes civile	Deçan	√	
6	Zyra e gjendjes civile	Irzniq		√
7	Zyra e gjendjes civile	Strellc i Epërm		√
8	Zyra e gjendjes civile	Drenoc		√
9	Gjykata	Deçan	√	

Tabela Nr. 34: Lista e shkollave në komunën e Deçanit dhe viti i fillimit të ndarjes së mbeturinave

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Viti 2020	Viti 2021
1	SHFMU "Sylejmon Vokshi"	Prilep		√
2	SHFMU "Bajram Curri"	Strellc i Epërm		√
3	SHFMU "Esad Mekuli"	Maznik		√
4	SHFMU "Dëshmorët e Kombit"	Strell i Ulët		√
5	SHFMU "Ardhmëria"	Beleg		√

6	SHFMU "Sylë Alaj"	Drenoc		√
7	SHFMU "Heronjtë e Dukagjinit"	Glllogjan		√
8	SHFMU "Lan Selimi"	Lumbardh		√
9	SHFMU "Avni Rrustemi"	Irzniq		√
10	SHFMU "Dëshmorët e Baballoqit"	Baballoq		√
11	SHFMU "Drita"	Gramaqel		√
12	SHFMU "Faik Konica"	Ratsih		√
13	SHFMU "Dëshmorët e Vokshit"	Pobërgjë		√
14	SHFMU "Jusuf Gërvall"	Prapaqan		√
15	SHFMU "Kuvendi i Verrave të Llukës"	Lluka e Epërme		√
16	SHFMU "Isa Bolitini"	Isnqi		√
17	SHFMU "Rexhep Kadrija"	Rastovic		√
18	SHFMU "Lidhja e Prizrenit"	Deçan	√	
19	SHMT "Tafil Kasumaj"	Deçan	√	
20	Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"	Deçan	√	
21	Paralele e SHFMU "Sylë Alaj"	Vokshë		√
22	Paralele e SHFMU "Lan Selimi"	Llukë e ulët		√
23	Paralele e SHFMU "Jusuf Gërvalla"	Dubovikë		√
24	Paralele e SHFMU "Isa Boletini"	Lëbushë		√
25	Qerdhja e femijëve "Fatosat" (private)	Deçan	√	

Tabela Nr.35: Lista e institucioneve të shërbimit shëndetësor dhe viti i fillimit të ndarjes së mbeturinave

Nr	Shërbimi publik shëndetësor	Lokacioni	Viti 2020	Viti 2021
1	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	Deçan	√	
2	Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF)	Isnqi		√
3	Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF)	Strellc i Epërm		√
4	Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF)	Irzniq		√
5	Njësi shëndetësore apo ambulanca	Prapaqan		√
6	Njësi shëndetësore apo ambulanca	Pobërgjë		√
7	Njësi shëndetësore apo ambulanca	Prelep		√
8	Njësi shëndetësore apo ambulanca	Lumbardh		√
9	Njësi shëndetësore apo ambulanca	Ratish i Ultë		√
10	Njësi shëndetësore apo ambulanca	Gramaqel		√

Në mënyrë që procesi i ndarjes të këtë sukses rekomandohet që komuna të bashkëpunojë ngushtë me operatorë të veçantë për të grumbulluar mbeturinat e ndara.

Përvojat e deritanishme në Kosovë kanë treguar që përfshirja e operatorit të veçantë në proces të ndarjes ka rezultuar e sukseshme në ato raste kur një operator i janë dhënë mundësitë për të grumbulluar të gjitha mbeturinat e reciklueshme në komunë. Mirëpo, nga praktika e deritanishme procesi i ndarjes gjithmonë rezulton me subvencionim nga ana e komunës në mënyrë që të rezultojë me ndarje të sukseshme.

Megjithatë çdo fraksion i ndarë duhet të grumbullohet nga kamionë të veçantë, operatorët e veçantë janë alternative mjaftë e mirë për të kryer këtë punë. Përfitimi ekonomik është një ndër arsye kryesore që i shtyn operatorët që të merren me këtë aktivitet. Benefitet janë të

dyanshme, dmth. komuna përfiton sepse sistemi do të funksionojë si duhet, ndërsa në të njëjtën kohë operatorët do të mund të përfitonin materialisht nga i gjithë procesi duke hapur edhe vende të reja pune, sado simbolike që do të ishin ato.

Për ndarjen në burim nëpër institucione komuna do të zbatojë një hulumtim në terren. Hulumtimi nënkupton vizitë në çdo objekt për të kuptuar planimetrinë dhe madhësinë e objekteve, dhe numrin e nxënësve dhe punonjësve. Ky hulumtim do t'i mundësojë komunës që të identifikojë më saktësi numrin e kontenjerave për ndarje si dhe llojin e tyre.

5.3.2.2 O5: Inicimi i ndarjes së mbeturinave në burim në amvisëri, në dy fraksione (të reciklueshme dhe të pa reciklueshme) deri në fund të viti 2021.

Hapësira e cila është përzgjedhur për të vazhduar është (komuna e përckaton lokacionin)

Shfrytëzimi i tokës në këtë zonë është kryesisht shtëpi individuale, objekte shumëbanesore dhe biznese të ndryshme. Ndarja e mbeturinave në burim do të përfshijë shtëpitë individuale sepse për inicim të procesit të ndarjes së mbeturinave është më lehtë të fillohet me shtëpi individuale për shkak të qasjes së lehtë në këtë zonë.

Amvisëritë në këtë zonë do të bëjnë ndarjen e mbeturinave në dy fraksione, në mbeturina të reciklueshme dhe në ato të pa reciklueshme. Në fraksionin e mbeturinave të reciklueshme hyn: letër, karton, plastike, PET, dhe kanaqe. Ndërsa në ato të pa-reciklueshme hyjnë të gjitha mbeturinat tjera. Komuna do të ofrojë dy kontenjerë të plastikës për çdo amvisëri, njëri do të shërbejë për mbeturina të reciklueshme dhe tjetri për ato të pa-reciklueshme.

Procesi i ndarjes së mbeturinave në burim në amvisëri konsiderohet hapi i fundit dhe më sfiduesi në ciklin e ndarjes së mbeturinave. Si i tillë ky proces do të zbatohet vetëm pasi që ndarja në burim ka përfunduar apo të paktën është intensifikuar në objektet publike dhe shkollat e komunës së Deçanit, dhe vetëm pasi që e gjithë komuna e Deçanit është përfshirë në shërbim të grumbullimit të mbeturinave.


Për ndarje në burim në shtëpi individuale (rreth 150) në vitin 2020 komuna e Deçanit do të buxhetojë për 300 kontenjerë të plastikës 120 lit.

5.3.2.3 O7: Ndarja e mbeturinave në hapësira publike nëpërmes ishujve ekologjik, në 2 lokacione deri në fund të viti 2021.

Krahas ndarjes së mbeturinave në burim, komuna e Deçanit do të instalojë edhe pika të grumbullimit për mbeturina të ndara apo të reciklueshme, apo ishuj ekologjik. Duke instaluar ishujt ekologjik komuna synon që të ulë sasinë e mbeturinave që shkojnë në deponi, të mbrojnë ambientin dhe në të njëjtën kohë të krijojë mundësi për bizneset lokale që të merren me aktivitetin e mbeturinave të reciklueshme.

Në këto pika qytetarët do të mund të hedhin mbeturinat e ndara në këto fraksione: letër/karton; PET/plastikë, metal, qelq; tekstil; dhe mbeturinat tjera. Qytetarët mund të hedhin mbeturinat e ndara në ishujt e ekologjik pa u aplikuar ndonjë tarifë. Nëse komuna e vëren që ka nevojë të instalohet edhe një fraksion tjetër, atëherë do të mund të kthejë njërin prej kontenjerëve për deponimin e mbeturinave të tjera në fraksion specifik, psh tekstil.

Figura Nr. 6: Përmbajtja dhe dizajni i ishujve të ekologjik



Ishujt e ekologjik do të instalohen në qendrën e qyteti, konkretisht në 2 lokacione. Lokacionet në të cilat do të instalohen ishujt ekologjik janë kryesisht hapësirat më të frekuentuara të qytetit dhe udhëkryqet e rrugëve. Është detyrë e drejtoratit të shërbimeve publike dhe në bashkëpunim me drejtoratin e urbanizmit të përcaktojë lokacionet në të cilat do të instalohen ishujt e ekologjik. Lokacionet e përzgjedhura duhet të jenë në pronë publike, duhet të kenë qasje të përshtatshme për kamion për zbrazen e kontejnerëve, qasje të përshtatshme për këmbësorë të cilët i hedhin mbeturinat, dhe përfundimisht nuk duhet të ndërtohen brenda parkingjeve ku qasja e kamionëve për zbraze është e vështirësuar.

Për këtë objektiv, komuna në vitin 2018/19 do të buxhetojë mjete për blerjen e kontejnerëve të plastikës 1.1m³, kontejnerë të plastikës 240 lit dhe rregullimin e hapësirave për vendosjen ishujve ekologjik.

5.3.2.4 O7: Inicimi i procesit të menaxhimit sistematik të mbeturinave të vëllimshme.

Menaxhimi i mbeturinave vëllimshme dhe të veçanta do të eliminojë problemin e bartjes së këtij lloji të mbeturinave së bashku me mbeturinat komunale të përditshme që krijon problem në transport si dhe në krijimin e deponive ilegale. Në qendrën për mbeturina të vëllimshme do të mund të deponoheshin fraksionet e mbeturinave si në vijim:

- Orendi shtëpiake, dyer, dritare, etj.,
- Pajisje shtëpiake (frigorifer, rrobalarëse, stufa, televizorë, kompjuterë, etj.,)
- Mbeturina të veçanta (bateri të automjeteve, gomat, etj.,)

Lokacioni në të cilin do të bëhet grumbullimi i mbeturinave të vëllimshme është fshati Lëbushë (në kuadër të deponisë ndërtimore si aneks i veçantë). Modeli i operimit për grumbullim të mbeturinave të vëllimshme mbetet i hapur, është detyrë e komunës që të analizojë situatën dhe të propozojë model të përshtatshëm për këtë lloj të mbeturinave deri në fund të vitit 2020.

5.3.2.5 O8: Krijimi i sistemit lokal të kompostimit

Një ndër synimet e komunës së Deçanit është që të ulë sasinë e mbeturinave biodegraduese/organike që shkojnë në deponi. Komuna do të instalojë sistem lokal të kompostimit nëpërmes së cilit do të inkurajojë qytetarët e saj të ndajnë dhe kompostojnë mbeturinat biodegraduese/organike.

Kompostimi është trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit – plehut nën kushte të kontrolluara. Mbeturinat e biodegradueshme janë mbeturinat nga kopshtet, parqet, ushqimet nga mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, shitoret me

pakicë dhe nga impiantet për përpunim të ushqimit. Siç u tha më lartë kompostimi e ulë sasisë e mbeturinave që shkojnë në deponi sepse me anë të këtij procesi mund të kompostohen mbeturinat organike, mbeturinat e gjelbërta të kopshtit dhe mbeturinat nga letra të cilat përbejnë deri 60% të mbeturinave.

Për këtë arsye komuna apo donatori do të ofrojnë kontenjerë të veçantë pa pagesë për kompostim për një lagje në qytet (150 enë kompostuese).

Për më shumë, komuna do të shtojë përpjekjet e saja që të fut në sistem lokal të kompostimit edhe amvisëritë tjera që shprehin interesim si dhe restorantet dhe impiantet për përpunim të ushqimit. Si kriter i mundshëm për ndarjen e enëve pa pagesë mund të jetë rregullsia e tyre në pagesën e tarifës për mbeturina si dhe gatishmëria për të zbatuar kompostimin.

Kompostimi është sfidë e veçantë duke marrë parasysh problemet me të cilat përballemi dhe shkallën e zhvillimit ekonomik. Sistemi i centralizuar i kompostimit nuk do të ishte zgjidhje për shkak të shpenzimeve të mëdha financiare që do të nevojiteshin për t'i kriju këto qendra si dhe sasisë së vogël të mbeturinave organike. Për këtë arsye komuna do të iniciojë krijimin e një sistemi lokal, i cili, varësisht nga përformanca do të mund të ngritet në nivel më të lartë.

Figura Nr. 7: Ena kompostuese



Për këtë objekt, komuna apo donatori në vitin 2020, do të buxhetojë mjete për blerjen e kontenjerëve të plastikës për kompostim, 150 kontenjerë.

5.3.3. Qëllimi 3: Grumbullimi, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogëlim të sasisë që përfundon në deponi.

5.3.3.1 O9: Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave shtazore

Menaxhimi i mbeturinave shtazore është i rregulluar më Udhëzimin Administrativ për Menaxhimin e Mbeturinave Biodegraduese. Mbeturinat shtazore janë mbeturinat e mishit, eshtrave dhe lëkurës që krijohen nga therrëtorët, mishoret dhe impiantet për përpunim të mishit. Mbeturinat shtazore janë pjesë e mbeturinave të veçanta për të cilat është përgjegjëse komuna. Praktika e deritashme e grumbullimit të përzier të mbeturinave komunale së bashku me ato shtazore është në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe e rrezikshme për shëndetin e njeriut. Kjo për shkak të ndikimit negativ në mjedis pasi që këto mbeturina të janë përzier, si dhe për shkak të implikimeve financiare gjatë deponimit të tyre në deponinë regjionale apo transfer stacion.

Meqenëse, në Kosovë ende nuk ekziston impiant i veçantë për trajtimin e mbeturinave shtazore, dhe derisa një zgjidhje e tillë të ofrohet nga niveli qendrorë, komuna e Deçanit është zotuar të përmirësojë sistemin e grumbullimit të mbeturinave shtazore duke bërë zgjidhje të përshtatshme provizore.

Komuna do të angazhojë operatorë të veçantë apo do të mundësojë makineri të veçantë për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave shtazore. Në të njëjtën kohë komuna do të sigurohet që bizneset që gjenerojnë mbeturina shtazore (mishtoret, therrëtorët, fabrikat për përpunim të mishit, dhe fermat) do të hyjnë në kontratë me operatorët e autorizuar si dhe do të sigurojnë kontenjerë të veçantë në të cilat do të deponohen mbeturinat shtazore. Kontenjerët e veçantë për mbeturina shtazore duhet të jenë rezistent ndaj korrozionit dhe të pa-përshkueshëm nga mbeturinat e lëngëta që lirohen nga këto mbeturina, në të njëjtën kohë kontenjerët duhet të jenë të pajisur me kapak mbyllës hermetik për mos kundërmim.

Figurat Nr. 8 dhe 9: Kontejnerët për mbeturina shtazore



Për këtë objektiv, komuna nëpërmes rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave apo një vendimi të veçantë do të kërkojë nga mishtorët, therrëtorët, dhe fermat që në afat deri në fund të vitit 2018 të pajisen me kontenjerë të veçantë për mbeturina shtazore. Momentalisht, në komunën e Deçanit operojnë nëntë mishtore dhe një therëtorë, mirëpo një analizë paraprake e komunës për numër të saktë të bizneseve të këtij lloji është e domosdoshme. Zbatimi i kësaj dispozite të rregullores apo vendimit do të bëhet nëpërmes inspektorëve mjedisor të komunës së Deçanit. Inspektorët e mjedisit do të kenë përkrahjen e zyrës së kryetarit që të kenë sukses në zbatimin e saj.

5.3.3.2 O10: Menaxhimi i qendrueshmë i mbeturinave medicinale

Edhe pse mbeturinat medicinale janë përgjegjësi e nivelit qendror, një pjesë e madhe e tyre përfundon në kontenjerat e përbashkët, të dezinfektuara dhe të pa dezinfektuara. Këto mbeturina krijojnë probleme për transportim dhe kontaminim të mbeturinave komunale.

Komuna, respektivisht drejtoria për shërbime publike, për shëndetësi, dhe inspekcioni, do të sigurojë që institucionet shëndetësore publike dhe private që operojnë në komunë janë të pajisur me kontejnera të veçantë në të cilat do të hedhen mbeturinat medicinale.

Komuna do të harmonizojë veprimet me Spitalin Rajonal në Pejë për të siguruar që institucionet shëndetësore (publike dhe private) kanë hyrë në kontratë me spitalin e Pejës për të deponuar mbeturinat medicinale.

NPK Higjiena nëse vëren se institucionet shëndetësore nuk janë të pajisur me kontejnerë të veçantë si dhe i deponojnë (hudhin) mbeturinat medicinale së bashku me mbeturinat komunale nuk duhet ti grumbullojë këto mbeturina dhe në të njëjtën kohë të lajmëroj inspektoratin për marrjen e hapave ligjor.

5.3.3.3 O11: Menaxhim i qendrueshëm i mbeturinave ndërtimore

Menaxhimi i mbeturinave ndërtimore është i rregulluar përmes Udhëzimit Administrativ MMPH nr. 07/2015. Mbeturinat ndërtimore janë lenda apo objekti i destinuar për braktisje të cilat krijohen gjatë ndërtimit, rindërtimit, renovimit, apo shkatërrimit të objekteve ndërtimore.

Mbeturinat nga ndërtimi dhe shkatërrimi i objekteve ndërtimore përfshijnë materialet si: gurë natyror, gurë të latuar, blloka, beton, drurë, plastik, qelq, mbeturinat e metalit etj.

Bartja e mbeturinave nga ndërtimi bëhet nga persona të licensuar dhe nga prodhuesi i mbeturinave, apo nga prodhuesi i mbeturinave me paisje adekuate. Në mënyrë që mbeturinat nga ndërtimi të trajtohen në mënyrë të qëndrueshme rekomandohet që komuna të angazhojë persona të licensuar që do të bëjnë bartjen e mbeturinave nga prodhuesit e mbeturinave.

Ky veprim është i domosdoshëm duke marrë parasysh se qytetarët po i hedhin mbeturinat në hapësira publike duke shkaktuar probleme mjedisore. Për më shumë komuna do t'i ofrojë kontratë bashkepunimi operatorit të licensuar për bartjen e mbeturinave nga ndërtimi për të trajtuar këto mbeturina. Ky veprim konsiderohet si incentivë për operatorët e licensuar për të trajtuar këto mbeturina më makineritë e tyre.

Lokacioni i përzgjedhur për ndërtimin e qendrës për trajtimin e mbeturinave ndërtimore është fshati Lëbushë.

5.3.4 Qëllimi 4: Reformat administrative

5.3.4.1 O12: Reformat administrative

O12.1 Themelimi i njesisë së menaxhimit për mbeturina

Komuna do të instalojë njësinë për menaxhim të mbeturinave brenda drejtoratit për shërbime publike. Njësia do të përmbajë të paktën një staf që do të ketë përgjegjësinë për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave.

Njësia për menaxhim të mbeturina do të jetë përgjegjëse për zbatimin e PKMM-së, dhe cdo staf i sajë do të ketë të hartuara detyrat dhe përgjegjësitë për vendin e tyre të punës⁸.

O12.2 Miratimi i rregullares për menaxhim të mbeturinave

Komuna, respektivisht drejtoria për shërbime publike do të hartojë dhe miratojë rregulloren për menaxhim të mbeturinave menjëherë pas miratimit të planit komunal për menaxhim të mbeturinave.

5.3.4.2 O13: Përcaktimi i tarifës për grumbullim, transportim dhe deponim të mbeturinave

Analiza e rrjedhes së parave në kompani dhe përcaktimi i tarifës, dhe përcaktimi i caceve për të arritur shkallën e dëshiruar të inkasimit.

5.3.5 Qëllimi 5: Vetëdijësimi

5.3.5.1 O14: Krijimi i kampanjës për vetëdijësim dhe informim rreth efekteve pozitive dhe negative të mbeturinave, rreth orarit dhe rregullave të grumbullimit dhe hedhjes së mbeturinave.

Kampanja e informimit dhe vetëdijësimi është e lidhur ngushtë me objektivat e mësipërme. Komuna do të përdorë kampanjën si mjet për të informuar qytetarët për reformat në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe për vetëdijësim.

Komuna duhet të dizajnojë kampanjën për vetëdijësim. Kampanja nënkupton logo dhe moto e komunës që do të përdorë për të ngritur vetëdijën e qytetarëve për reformën në fushën e menaxhimit të mbeturinave që do të zbatohet në komunë. Kampanja do të fokusohet në fushat në vijim:

⁸ Ky objektivi konsiderohet i përmbushur meqë komuna ka emëruar zyrtarin e MM në kuader të DSHP

Zgjerimi i shërbimeve – si prioritet i komunës, komuna do të organizojë takime me banorët e vendbanimeve të cilat do të hyjnë në shërbim. Çdo zgjerim i shërbimit për çdo vendbanim do t'i paraprijë t'paktën një takim publik me banorë. Në të njejtën kohë, komuna do të organizojë ligjerata për shkollat e fillore dhe të mesme për të ngritur vetëdijën e nxënësve rreth procesi të menaxhimit të mbeturinave, dhe efektet pozitive dhe negative të mbeturinave.

Ndarja në burim në shkolla dhe institucione – komuna do të organizojë takime dhe ligjerata me nxënësit e shkollave, mësimdhënësit, dhe punonjësit e institucioneve publike për të shpjeguar procesin e ndarjes së mbeturinave dhe përfitimet nga ky proces. Komuna do të shtyp broshura ku do të shpjegohet në mënyrë të qartë procesi i ndarjes së mbeturinave.

Ndarja në burim në amvisëri – komuna do të organizojë takime lagje për lagje duke ju spejguar procesin e ndarjes së mbeturinave në burim dhe përfitimet nga ky proces. Komuna do të shtyp broshure të cilat do të shpjegojnë qartë këtë proces si dhe kohën e operatorëve për mbledhjen e këtyre mbeturinave.

Ishujt ekologjik, lokacioni për pranimin e mbeturinave të vëllimshme koha për mbledhjen e mbeturinave të vëllimshme – komuna do të informojë qytetarët për ishujt e ekologjik, lokacionin për mbeturinat e vëllimshme dhe kohën për mbledhjen e këtyre mbeturinave përmes broshurave dhe takimeve me qytetarë.

6 Plani financiar

Plani financiar përmban projeksionin e kostove dhe të hyrave për periudhën pesëvjeqare në funksion të realizimit të objektivave të përmbajtura në PKMM. Në vijm janë të dhëna kostot historike për 2017 si dhe projeksionet e kostove dhe të hyrave për periudhën 2018 - 2022.

6.3 Projektioni i kostove të shërbimit

Projeksioni i kostove është reflektiv në zgjerimin e nivelit të shërbimit, rritjes së mbeturinave të cilat do të gjenerohen dhe grumbullohen, futjes së shërbimeve të reja, investime të reja e kështu me radhë.

Tabela Nr. 36: Parametrat relevant operativ

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i popullsisë	40,343	40,670	41,000	41,332	41,667	42,005
Numri i amviserive	5,935	5,983	6,031	6,080	6,129	6,179
Numri i banorëve të shërbyer	11,229	25,212	41,000	41,332	41,667	42,005
Numri i amviserive të shërbyera	1,677	3,748	6,031	6,080	6,129	6,179
Shkalla e mbulimit me shërbim	28.3%	62.6%	100%	100%	100%	100%
Sasia e gjeneruar e mbeturinave	12,075	12,469	12,720	13,125	13,536	13,799
Sasia e gjeneruar e mbeturinave për banor	0.82	0.84	0.85	0.87	0.89	0.9
Sasia e mbledhur e mbeturinave	3,380	5,586	12,720	13,125	13,536	13,799
Kapaciteti grumbullues		22,865	29,539	34,048	34,952	36,112
Numri i aseteve në operim	2	4	6	6	6	6
Numri i mbikqyrësve - Grumbullim	1	1	1	1	1	1
Numri i vozitësve - Grumbullim	4	6	8	8	8	8
Numri puntorëve Grumbullim	6	8	15	15	15	15

Kosto e përlllogaritura përfshijnë koston e plotë të menaxhimit të mbeturinave përfshi kostot operative dhe kostot investive. Po ashtu kostot përfshijnë kostot e ofrimit të shërbimit të mbeturinave dhe kostove tjera të cilat barten nga NPK Higjiena apo nga Komuna.

Premisat në të cilat janë zhvilluar kostot e MM përfshijnë:

- Zgjerimi i zonës së shërbimit do të arrihet i plotë përgjatë vitit 2019,
- Zgjerimi i shërbimit në periudhën planifikuese do të bëhet nga ofruesi aktual i shërbimeve,
- Ngrirja e regrutimit të stafit shtesë administrativ përgjatë periudhës planifikuese

6.3.3 Kostot direkte dhe administrative

6.3.3.1 Kostot direkte

Kostot direkte përfshijnë kostot direkte të grumbullimit të mbeturinave si dhe kostot e pastrimit të rrugëve dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike. Kostot direkte përbëhen nga kostot e stafit direkt (pagat dhe sigurimet), kostot e materialit harxhues si nafta, vaji dhe gomat.

Si bazë e kostove është marrë viti 2017 duke i bërë projeksionet e duhura përgjatë viteve planifikuese.

6.3.3.2 Kosto e stafit direkt

Kostoja e stafit është reflektive në numrin e kamionëve aktiv që bëjnë grumbullimin e mbeturinave, d.m.th. çdo kamioni aktiv i shoqërohet nga një vozitës dhe dy ndihmës (shtuar për stafin rezervë) si dhe mbikëqyrësit operativ.

Tabela Nr. 37: Kosto e stafit direkt

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Mbikëqyrës	4,200 €	4,200 €	4,200 €	4,200 €	4,200 €	4,200 €
Numri stafit	1	1	1	1	1	1
Paga bazë	300 €	300 €	300 €	300 €	300 €	300 €
Sigurimet sociale	50 €	50 €	50 €	50 €	50 €	50 €
Shoferë	14,400 €	21,600 €	28,800 €	28,800 €	28,800 €	28,800 €
Numri stafit	4	6	8	8	8	8
Paga bazë	250 €	250 €	250 €	250 €	250 €	250 €
Sigurimet sociale	50 €	50 €	50 €	50 €	50 €	50 €
Punëtorë	17,280 €	23,040 €	43,200 €	43,200 €	43,200 €	43,200 €
Numri stafit	6	8	15	15	15	15
Paga bazë	190 €	190 €	190 €	190 €	190 €	190 €
Sigurimet sociale	50 €	50 €	50 €	50 €	50 €	50 €
Nr. I stafit direkt	11	15	24	24	24	24
Kosto e stafit	35,880 €	48,840 €	76,200 €	76,200 €	76,200 €	76,200 €

6.3.3.3 Kosto e materialit harxhues

Kosto e materialit harxhues është në funksion të rrugës së përshkuar për grumbullimin dhe transferin e mbeturinave. Treguesit e performancës për harxhimin e naftës vajërave dhe kostove direkte për vitin 2017 janë marrë si vlera bazike duke përvetësuar përmirësime të këtyre treguesve përgjatë viteve në vijim.

Tabela Nr. 38: Kosto e materialit direkt

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Nr i kamionëve në operim	2	4	6	6	6	6
Mbeturinat e grumbulluara	3,380 t	5,586 t	12,720 t	13,125 t	13,536 t	13,799 t
Naftë	18,449 €	24,580 €	48,973 €	46,200 €	44,667 €	45,536 €
Konsumi l	17,082 l	22,346 l	44,521 l	42,000 l	40,607 l	41,396 l
Konsumi l/t	5.1 l/t	4.0 l/t	3.5 l/t	3.2 l/t	3.0 l/t	3.0 l/t
Kosto njësi €/l	1.08 €/l	1.10 €/l	1.10 €/l	1.10 €/l	1.10 €/l	1.10 €/l
Vaj motorrik	1,083 €	1,271 €	1,558 €	1,378 €	1,421 €	1,449 €
Konsumi l	361 l	363 l	445 l	394 l	406 l	414 l
Konsumi l/1,000t	107 l/1,000t	65 l/1,000t	35 l/1,000t	30 l/1,000t	30 l/1,000t	30 l/1,000t
Kosto njësi €/l	3.00 €/l	3.50 €/l	3.50 €/l	3.50 €/l	3.50 €/l	3.50 €/l
Vaj hidraulik	0 €	1,271 €	1,558 €	1,378 €	1,421 €	1,449 €
Konsumi l	0 l	363 l	445 l	394 l	406 l	414 l
Konsumi l/1,000t	0 l/1,000t	65 l/1,000t	35 l/1,000t	30 l/1,000t	30 l/1,000t	30 l/1,000t
Kosto njësi €/t	3 l/1,000t	3.50 €/l	3.50 €/l	3.50 €/l	3.50 €/l	3.50 €/l
Goma	3,629 €	3,600 €	5,400 €	5,400 €	5,400 €	5,400 €
Copë	0 copë	24 copë	36 copë	36 copë	36 copë	36 copë
Kosto njësi	#DIV/0!	150 €/copë	150 €/copë	150 €/copë	150 €/copë	150 €/copë
Akumulatorë	440 €	0 €	450 €	450 €	450 €	450 €

Copë	0 copë	2 copë	3 copë	3 copë	3 copë	3 copë
Kosto njësi	#DIV/0!	150 €	150 €	150 €	150 €	150 €
Rexhistrimi	440 €	2,000 €	3,000 €	3,000 €	3,000 €	3,000 €
Kamion	1 mjet	4 mjet	6 mjet	6 mjet	6 mjet	6 mjet
Kosto njësi	440 €/mjet	500 €/mjet	500 €/mjet	500 €/mjet	500 €/mjet	500 €/mjet
Pjesët rezervë	0 €	900 €	3,300 €	3,300 €	3,300 €	3,300 €
Pjesët rezervë njësi	0 €/mjet	225 €/mjet	550 €/mjet	550 €/mjet	550 €/mjet	550 €/mjet
Total:	24,041 €	33,622 €	64,239 €	61,106 €	59,660 €	60,583 €

6.3.3.4 Kostot e deponimit

Projeksionet e kostove të deponimit janë bërë duke u bazuar në vlerat historike të vitit 2017 dhe përfshijnë mbeturinat e grumbulluara duke aplikuar tarifën e KRM Ambineti për shërbimin e deponisë. Projeksionet e kostos së deponimit nuk parshohin ngritjen e tarifës së deponimit.

Tablea Nr. 39: Kosto e deponimit të mbeturinave

Kostoja për KMDK	10,140 €	16,759 €	38,161 €	39,375 €	40,607 €	41,396 €
Mbeturinat e grumbulluara	3,380 €	5,586 €	12,720 €	13,125 €	13,536 €	13,799 €
Kosto njësi e deponimit	3.0 €/t	3.0 €/t	3.0 €/t	3.0 €/t	3.0 €/t	3.0 €/t

Në tabelën në vijim janë dhënë në mënyrë të përmblëdhur kosto direkte të menagjimit të mbeturinave.

Tabela Nr. 40: Kostot direkte të MM

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Kosto direkte	70,061	99,221	178,600	176,681	176,466	178,179
Pagat direkte	35,880	48,840	76,200	76,200	76,200	76,200
Nr. i mbikëqyrësve	1	1	1	1	1	1
Nr. i shoferëve	4	6	8	8	8	8
Nr. i punëtorëve	6	8	15	15	15	15
Materiali direkt	23,601 €	33,622 €	64,239 €	61,106 €	59,660 €	60,583 €
Naftë	18,449	24,580	48,973	46,200	44,667	45,536
Vaj motorrik	1,083	1,271	1,558	1,378	1,421	1,449
Vaj hidraulik	-	1,271	1,558	1,378	1,421	1,449
Goma	3,629	3,600	5,400	5,400	5,400	5,400
Akumulatorë	-	-	450	450	450	450
Rexhistrimi	440	2,000	3,000	3,000	3,000	3,000
Pjesët rezervë	-	900	3,300	3,300	3,300	3,300
Kostoja per KMDK	10,140	16,758	38,160	39,375	40,608	41,397

6.3.3.5 Kostot indirekte dhe administrative

Kostot indirekte dhe administrative përfshijnë pagat indirekte të NPK Higjiena, shpenzimet administrative si dhe kostot e fushatave vetëdijësuese të cilat do i organizoj komuna. Duke pasur për bazë se NPK Higjiena ka të angazhuar një staf të madh administrativ, për rrjedhojë plani nuk parasheh ngritje të mëtejme të kostove administrative përgjatë periudhës planifikuese si në regrutimin e stafit të ri ashtu edhe në shpenzimet përcjellëse.

Sa i përket fushatave vetëdijësuese ato do të fillojnë nga viti 2018 dhe do të jenë kontinuele. Ato do të përfshijnë transmetime të mesazheve audiovizuale me transmetuesit lokal, shtypjen e fletushkave si dhe takimet me qytetarët duke përfshi këtu edhe nxënësit.

Përmes këtyre fushatave qytetarëve do iu jepen informata relevante mbi menaxhimin e mbeturinave, formave të avancuara të menaxhimit të mbeturinave si reduktimi, ndarja në burim, ripërdorim, riciklimi, mbeturinat shatzore, mbeturinat e vëllimshme, mbeturinat inerte e kështu me radhë. Qytetarët do të njihen me informata relevante si orari i shërbimit dhe mënyra e shërbimit, ofrimi i shërbimeve tjera si hudhja e mbeturinave të vëllimshme dhe inerte, ndarja e mbeturinave, ishujt ekologjik dhe të ngjashme.

Tabela Nr. 41: Shpenzimet indirekte dhe administrative

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Kosto indirekte dhe administ.	34,035	40,035	40,035	40,035	40,035	40,035
Nga NPK Higjiena	34,035	34,035	34,035	34,035	34,035	34,035
Pagat e administratës	27,060	27,060	27,060	27,060	27,060	27,060
Kosto tjera administrative	6,975	6,975	6,975	6,975	6,975	6,975
Nga Komuna	-	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000
Kampanja vetdijësuese		6,000	6,000	6,000	6,000	6,000

6.3.4 ProjekSIONET E KOSTOVE KAPITALE

Kostot investive përfshijnë kostot kapitale për:

- sigurimin e kamionëve për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave,
- sigurimin e kontejnerëve publik dhe individual për grumbullimin e mbeturinave,
- sigurimin e kontejnerëve dhe infrastrukturës përcjellëse për ndarje dhe riciklim,
- sigurimin e enëve kompostuese, dhe
- investimet në deponinë e materialit inert.

6.3.4.1 Kostot investive për kamionë

NPK Higjiena posedon një park me gjithësejtë 3 kamionë por që të gjithë këta kamionë e kanë kaluar jetën e tyre ekonomike dhe si të tillë duhet t zëvendësohen. Plan i investiv është bazuar në nevojat e përlogaritura në planin operativ për kamionë shtesë të cilët janë në total 6. Këta kamionë do të jenë me kapacitet prej 7,5 ton të tipit kompaktorë.

6.3.4.2 Kostot investive për kontejnerë

NPK Higjiena posedon një kontigjent të kontejnerëve 1.1 m3 por që të gjithë e kanë tejkaluar jetën e tyre ekonomike gjë që kërkon zëvendësimin e tyre me kontejnerë të rinj. Poashtu zgjerimi i shërbimeve nënkupton sigurimin e kontejnerëve të plastikës 120 litra dhe sasia e tyre është bazuar në planin e zgjerimit sipas fazave.

6.3.4.3 Kostot investive për riciklim dhe ndarje

Në këto kosto përfshihen kostot e investimit në projektin e ishujve ekologjik, koston e sigurimit të kontejnerëve plastik me ngjyrë 120 lit për ndarjen e mbeturinave në burim sipas llojit, kostot e enëve kompostuese si dhe ndërtimin e deponise komunale për mbeturina inerte dhe të vëllimshme

Në tabelën në vijim janë ofruar të dhëna të detajuara mbi investimet kapitale përgjatë periudhës 2017-2021.

Tabela Nr 42: Lista dhe përshkrimi i projekteve kapitale

Investimet në vitin 2018					
Tipi i investimit	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Arsyetim shtesë	Ndërlidhja e investimit me objektivat
4 kamion kompaktues me kapacitet ngarkues 7.5 ton për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave	4	85,000 €	340,000 €	NPK Higjiena operon me 3 kamionë të cilët janë në gjendje të keqe. Përmes sigurimit të kytyre kamionëve NPK Higjiena do të siguroj kapacitetin operativ, ngris cilësinë e shërbimeve dhe do reduktoj kostot e operimit dhe mirëmbajtjes	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë teritorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.
Kontenjera të plastikës 120 lit.	2,100	20 €	44,000 €	NPK Higjiena është përcaktuar për modelin e grumbullimit derë më derë për konsumatorët e amvisërive dhe bizneseve pa kontrat për zonën periurbane dhe zonat rurale. Sigurimi i këtyre kontejnerëve është drejtpërdrejt në funksion të futjes së konsumatorëve të ri në sistem.	O3: Optimizimi i sistemit të grumbullimit mbeturinave.
Kontejnerë 1.1 m3	90	315	28,350	Kontejnerët 1.1 m3 shërbejnë për ofrimin e shërbimit të mbeturinave për banesa kolektive, institucione, dhe dyqante në zonën urbane. Jetëgjatësia e këtyre kontejnerëve është 3 vjet dhe që të gjithë kontejnerët e NPK Higjiena janë më të vjetër dhe të tejarmortizuar.	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë teritorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.
Totali 2018			412,350		
Investimet në vitin 2019					
Tipi i investimit	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Arsyetim shtesë	Ndërlidhja e investimit me objektivat
2 kamion kompaktues me kapacitet ngarkues 7.5 ton për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave	2	85,000 €	170,000 €	NPK Higjiena operon me 3 kamionë të cilët janë në gjendje të keqe. Përmes sigurimit të kytyre kamionëve NPK Higjiena do të siguroj kapacitetin operativ, ngris cilësinë e shërbimeve dhe do reduktoj kostot e operimit dhe mirëmbajtjes	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë teritorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.

Kontenjera të plastikës 120 lit.	2,300	20 €	46,000 €	NPK Higjiena është përcaktuar për modelin e grumbullimit derë më derë për konsumatorët e amvisërive dhe bizneseve pa kontrat për zonën periurbane dhe zonat rurale. Sigurimi i këtyre kontejnerëve është drejtpërdrejt në funksion të futjes së konsumatorëve të ri në sistem.	O3: Optimizimi i sistemit të grumbullimit mbeturinave.
Kontejnerë 1.1 m3	120	315	37,800	Kontejnerët 1.1 m3 shërbejnë për ofrimin e shërbimit të mbeturinave për banesa kolektive, institucione, dhe dyqante në zonën urbane. Jetëgjatësia e këtyre kontejnerëve është 3 vjet dhe që të gjithë kontejnerët e NPK Higjiena janë më të vjetër dhe të tejamortizuar.	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë teritorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.
Ndërtimi i garazhit për autopark	1	50,000 €	50,000 €	NPK Higjiena për momentin nuk ka garazhë adekuate për kamionët e sajë të cilët duke qëndruar pa mbulesë dëmtohen dhe amortizohen. Përmes këtij investimi realizohet ndërtimi i garazhit (mbulesës dhe mureve anësore) me hapësirë prej 800 m2.	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë teritorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.
Totali Kosto Investive në 2019			303,800 €		
Investimet në vitin 2020					
Tipi i investimit	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Arsyetim shtesë	Ndërlidhja e investimit me objektivat
Kontejnerë 1.1 m3	40	315	12,600 €	Kontejnerët 1.1 m3 shërbejnë për ofrimin e shërbimit të mbeturinave për banesa kolektive, institucione, dhe dyqante në zonën urbane. Jetëgjatësia e këtyre kontejnerëve është 3 vjet dhe që të gjithë kontejnerët e NPK Higjiena janë më të vjetër dhe të tejamortizuar.	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë teritorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.
Rregullimi i hapësirës – bazamentit dhe rrethojave për vendosjen e ishujve ekologjik	2	500 €	1,000 €	Ndarja e mbeturinave në burim është një praktikë e mirë e cila mundëson ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave në burim ku operatori mund të grumbulloj mbeturinat e caktuara të cilat do ti procesoj si dhe sasia e zvogëluar e mbeturinave që do të depozitohet në deponi do të ulë kostot e deponimit si dhe do të ulë impaktin mjedisor nga mbingarkimi me mbeturina të deponive	O7: Ndarja e mbeturinave në hapësira publike nëpërmes ishujve ekologjik

Kontenjera të plastikës 1.1 m³ - kontenjerë me ngyrë të cilët do të vendosën në ishujt ekologjik	8	270 €	2,160 €	Ndarja e mbeturinave në burim është një praktikë e mirë e cila mundëson ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave në burim ku operatori mmundë të grumbulloj mbeturinat e caktuara të cilat do ti procesoj si dhe sasia e zvogëluar e mbeturinave që do të depozitohet në deponi do të ulë kostot e deponimit si dhe do të ulë impaktin mjedisor nga mbingarkimi me mbeturina të deponive	O7: Ndarja e mbeturinave në hapësira publike nëpërmes ishujve ekologjik
Kontenjera të plastikës 240 lit - kontenjerë me ngyrë të cilët do të vendosën në ishujt ekologjik	2	35 €	70 €	Ndarja e mbeturinave në burim është një praktikë e mirë e cila mundëson ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave në burim ku operatori mmundë të grumbulloj mbeturinat e caktuara të cilat do ti procesoj si dhe sasia e zvogëluar e mbeturinave që do të depozitohet në deponi do të ulë kostot e deponimit si dhe do të ulë impaktin mjedisor nga mbingarkimi me mbeturina të deponive	O7: Ndarja e mbeturinave në hapësira publike nëpërmes ishujve ekologjik
Kontenjera të plastikës 120 lit.	300	20 €	6,000 €	NPK Higjiena është përcaktuar për modelin e grumbullimit derë më derë për konsumatorët e amvisërive dhe bizneseve pa kontrat për zonën periurbane dhe zonat rurale. Sigurimi i këtyre kontejnerëve është drejtpërdrejt në funksion të futjes së konsumatorëve të ri në sistem.	O3: Optimizimi i sistemit të grumbullimit mbeturinave.
Kontenjera të plastikës 120 lit – kontenjerët me ngjyrë	300	20 €	6,000 €	Këta kontejnerë me ngjyrë do të përdoren në pilot zona për ndarjen e mbeturinave. Komuna do të përzgjedh një lagje prej 150 amvisërive me shtëpi individuale në pjesën urbane të qytetit ku do të zbatohet ndarja e mbeturinave në burim në të riciklueshme dhe të pa riciklueshme.	O5: Inicimi i ndarjës së mbeturinave në burim në amvisëri, në dy fraksione (të riciklueshme dhe të pa riciklueshme), deri në fund të vitit 2021.
Enë për kompostim	150	75 €	11,250 €	Komuna do të implementoj skemën e kompostimit lokal për 150 amvisëri. Enët kompostuese parshihet të sigurohen nga donatori.	O8: Krijimi i sistemit lokal të kompostimit.
Investimet ne infrastrukturë për qendrën grumbulluese për mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi	1	250,000 €	250,000 €	Komuna ka marrë përsipër ofrimin e lokacionit të përshtatshëm në fshatinë Lepushë për ndërtimin e deponisë së mbeturinave ndërtimore dhe nga demolimet. Kosto e investimeve pra nuk përfshin kostot e tokës por kostot e makinerisë dhe pajisjeve për funksionimin normal të deponisë	O11: Menagjim i qendrueshëm i mbeturinave ndërtimore.
Totali Kosto Investive në 2020			289,080 €		
Investimet në vitin 2021					

Tipi i investimit	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Arsyetim shtesë	Ndërlidhja e investimit me objektivat
Kontejnerë 1.1 m3	40	315	12,600 €	Kontejnerët 1.1 m3 shërbejnë për ofrimin e shërbimit të mbeturinave për banesa kolektive, institucione, dhe dyqante në zonën urbane. Jetëgjatësia e këtyre kontejnerëve është 3 vjet dhe që të gjithë kontejnerët e NPK Higjiena janë më të vjetër dhe të tejamortizuar.	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë teritorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.
Kontenjera të plastikës 120 lit.	300	20 €	6,000 €	Sigurimi i këtyre kontejnerëve është në funksion të ripërtëritjes së kontejnerëve të amortizuar meqë jeta ekonomik e tyre është tri vite	O3: Optimizimi i sistemit të grumbullimit mbeturinave.
Totali Kosto Investive në 2021			18,600 €		
Investimet në vitin 2022					
Tipi i investimit	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Arsyetim shtesë	Ndërlidhja e investimit me objektivat
Kontejnerë 1.1 m3	40	315	12,600 €	Kontejnerët 1.1 m3 shërbejnë për ofrimin e shërbimit të mbeturinave për banesa kolektive, institucione, dhe dyqante në zonën urbane. Jetëgjatësia e këtyre kontejnerëve është 3 vjet dhe që të gjithë kontejnerët e NPK Higjiena janë më të vjetër dhe të tejamortizuar.	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë teritorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.
Kontenjera të plastikës 120 lit.	300	20 €	6,000 €	Sigurimi i këtyre kontejnerëve është në funksion të ripërtëritjes së kontejnerëve të amortizuar meqë jeta ekonomik e tyre është tri vite	O3: Optimizimi i sistemit të grumbullimit mbeturinave.
Totali Kosto Investive në 2022			18,600 €		

Tabela përmbledhëse e investimeve për periudhën e planifikimit është paraqitur në tabelat e më poshtëme:

Tabela Nr 43: Lista e konsoliduar e investimeve

Investimet Kapitale	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Për grumbullim dhe pastrim						
Kamionet	-	4 * 7.5 ton	2 * 7.5 ton	-	-	-
Kontejneret 120 lit	-	2,100	2,300	300	300	300
Kontejneret 1.1 m3	-	90	120	40	40	40
Ndertimi i Garazhit te Autoparkut	-	-	1	-	-	
Për ndarje dhe riciklim	-					
Kontjenerët për riciklim dhe ndarje (120 l)	-	-	150	-	-	-
Implementimi i projektit "ishujt ekologjik"	-	-	8 (1.1m3) 2 (240lit)	-	-	-
Enët kompostuese	-	-	150	-	-	-
Deponia e Materialeve Inerte	-	-	-	1 deponi	-	-

Tabela Nr. 44: Projeksionet e investimeve kapitale

	2018	2019	2020	2021	2022
Kostot e investimeve kapitale	412,350	303,800	289,080	18,600	18,600
Për grumbullim dhe pastrim	12,350	303,800	18,600	18,600	18,600
Kamionet	340,000	170,000	-	-	-
Kontejneret 120 lit /240 lit	44,000	46,000	6,000	6,000	6,000
Kontejneret 1.1 m3	28,350	37,800	12,600	12,600	12,600
Ndertimi i Garazhit te Autoparkut	-	50,000	-	-	-
Për ndarje dhe riciklim	-	-	270,480	-	-
Kontjenerët për riciklim dhe ndarje në burim	-	-	6,000	-	-
Implementimi i projektit "ishujt ekologjik"	-	-	3,230	-	-
Enët kompostuese	-	-	11,250	-	-
Deponia e Materialeve Inerte	-	-	250,000	-	-


6.3.5 Përmbledhje e projeksionit të kostove

Projeksionet e kostos së menaxhimit të mbeturinave përfshijnë kostot direkte, kostot administrative dhe kostot kapitale. Kostot totale të shërbimit janë të dhëna në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 45: Projektionet e kostove të MM

Kostot e Menaxhimit të Mbeturave	2018	2019	2020	2021	2022
Kosto Direkte	99,221	178,600	176,681	176,466	178,179
Pjesëmarrja e KD %	18.0%	34.2%	34.9%	75.1%	75.2%
Kostot administrative	40,035	40,035	40,035	40,035	40,035
Pjesëmarrja e KD %	7.3%	7.7%	7.9%	17.0%	16.9%
Kostot kapitale	412,350	303,800	289,080	18,600	18,600
Pjesëmarrja e KK %	74.8%	58.2%	57.2%	7.9%	7.9%
Total kostot e MM	551,606	522,435	505,796	235,101	236,814
Ngritja/zbritja e kostove totale	-	-5.3%	-3.2%	-53.5%	0.7%

Grafiku Nr. 2: Pjesëmarrja e kostove të MM



Duke u bazuar nga të dhënat e mësipërme kategoria kryesore e kostove paraqitet kostot direkte e pasuar nga kostot kapitale dhe kostot indirekte.

6.4 Projektionet e të hyrave dhe arkëtimit

Të hyrat kryesore janë të hyrat nga tarifat e shërbimit dhe të hyrat nga pastrimi i rrugëve. Zgjerimi i zonës së shërbimit ndikon në rritjen e të hyrave nga amvisëritë dhe bizneset e vogla ndërsa kjo rritje nuk pritet të ketë efekt tek bizneset e medha me kontrata dhe institucionet të cilat edhe ashtu janë të mbuluara me shërbim. Projektioni i të hyrave bazohet në tarifat aktuale të shërbimit si dhe në nivelin e kontraktuar të shërbimeve të pastrimit të rrugëve të kontraktuara me komunën.

Shkalla e arkëtimit luan një rol të veçantë meqë keshi i arkëtuar (dhe jo faturimi) shërben për mbulimin e kostove të menaxhimit të mbeturave. Projektioni i keshit të arkëtuar parasheh përmirësim të shkallës së arkëtimit përgjatë periudhës planifikuese për amvisëritë dhe bizneset si dhe arkëtimin e plotë për institucionet .

Tabela Nr. 46: Projektioni i të hyrave të shërbimit

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Të hyrat e NPK Higjiena	122,465	182,109	276,003	334,460	349,087	370,084
Nr. i Amvisërive të Shërbyera	1,677	3,748	6,031	6,080	6,129	6,179

Amvisëritë	55,264	106,439	191,864	237,618	239,541	241,483
Biznesi	33,876	42,345	50,814	63,518	76,221	95,276
Institucionet	33,325	33,325	33,325	33,325	33,325	33,325

Tabela Nr. 47: Projektioni i keshit të arkëtuar

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Total Arkëtimi	114,191	159,791	239,601	289,290	301,722	319,570
Amvisëritë	44,628	90,473	163,084	201,975	203,609	205,261
Amvisëritë %	80.8%	85%	85%	85%	85%	85%
Biznesi	27,739	35,993	43,192	53,990	64,788	80,985
Biznesi %	81.9%	85%	85%	85%	85%	85%
Institucionet	41,824	33,325	33,325	33,325	33,325	33,325
Institucionet %	126%	100%	100%	100%	100%	100%

6.5 Mbulimi i kostos dhe financimi i programit të MM

6.5.3 Mbulimi i kostos së MM


Të hyrat e shërbimit i referohen të hyrave nga grumbullimi i mbeturinave, pastrimit të rrugëve dhe shërbimeve tjera sekondare dhe këto të hyra realizohen përmes NPK Higjiena. Ndërsa kosto e MM përfshin të gjitha kostot e menaxhimit të mbeturinave përfshi kostot e grumbullimit, pastrimit dhe deponimit që pësohen nga NPK Higjiena si dhe kostot e ndarjes, riciklmit dhe procesimit të mbeturinave që mbarten nga Komuna apo ndonjë operator privat.

Të hyrat e shërbimit nuk i mbulojnë kostot e menaxhimit të mbeturinave përgjatë tërë periudhës planifikuese 2018 - 2020 ndërsa mbulimi i kostove të grumbullimit dhe pastrimit nuk mund të mbulohet për periudhën 2018 - 2019. Nëse analizohet mbulimi i kostos së grumbullimit atëherë vërehet se NPK Higjiena me të hyrat e projektuara do ti mbulojë kostot rrjedhëse të grumbullimit dhe pastrimit përgjatë tërë periudhës planifikuese ndërsa mbulimi i kostove kapitale të grumbullimit dhe pastrimit për vitin 2018 është 29.3 %, vitin 2019 46.4 % ndërsa për vitet 2020 - 2022 ai është i plotë.

Tabela Nr. 48: Mbulimi me të hyra i kostove të MM

Mbulimi i kostos	2018	2019	2020	2021	2022
Të hyrat e shërbimit (NPK Higjiena)	182,109	276,003	334,460	349,087	370,084
% e arkëtimit	88%	87%	86%	86%	86%
Total keshi i arkëtuar	159,791	239,601	289,290	301,722	319,570
Total kostot e MM	551,606	522,435	505,796	235,101	236,814
Boshllëku (teprica) MM	(391,815)	(282,834)	(216,506)	66,621	82,756
Mbulimi i kostos së MM	29.0%	45.9%	57.2%	100%	100%
Total kostot e grumbullimit dhe pastrimit	545,606	516,435	229,316	229,101	230,814
Mbulimi i kostos së grumbullimit dhe pastrimit	29.3%	46.4%	100%	100.0%	100.0%
Kosto rrjedhëse e grumbullimit dhe pastrimit	133,256	212,635	210,716	210,501	212,214
% e mbulimit të kostove rrjedhëse të grumbullimit	100%	100%	100%	100%	100%
Raporti i efikasitetit (të hyrat/kostot rrjedhëse)	1.4	1.3	1.6	1.7	1.7
Kosto kapitale të grumbullimit dhe pastrimit	412,350	303,800	18,600	18,600	18,600
% e mbulimit të kostove kapitale të grumbullimit	6.4%	8.9%	100%	100.0%	100.0%

Grafiku Nr. 3: Përqindja e mbulimit të kostove nga të hyrat e arkëtuara



6.5.4 Burimet e financimit të kostove operative

Financimimi i aktiviteteve për grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimit të hapësirave publike duhet të bëhen nga ofruesi i shërbimeve përfshi këtu edhe sigurimin e kostove kapitale. Edhe projeksionet e të hyrave dhe keshit të arkëtuar janë të mjaftueshme për mbulimin e kostove rrjedhëse të grumbullimit dhe pastrimit.

Tabela Nr. 49: Financimi i kostove operative

Financimi i kostove operative	2017	2018	2019	2020	2021
Total kosto direkte	99,221	178,600	176,681	176,466	178,179
Pagat	48,840	76,200	76,200	76,200	76,200
Kostot tjera Direkte	33,622	64,239	61,106	59,660	60,583
Kostot administrative të MM	40,035	40,035	40,035	40,035	40,035
Pagat e administratës NPK Higjiena	27,060	27,060	27,060	27,060	27,060
Shpenzimet tjera administrative NPK Higjiena	6,975	6,975	6,975	6,975	6,975
Fushata të vetëdijsimit	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000
Total kostot rrjedhëse të MM	139,256	218,635	216,716	216,501	218,214
Financuar nga NPK Higjiena (EUR)	133,256	212,635	210,716	210,501	212,214
nga NPK Higjiena %	95.7%	97.3%	97.2%	97.2%	97.3%
Financuar nga Komuna (EUR)	6,000	5,000	5,000	5,000	5,000
Nga Komuna %	4.31%	2.29%	2.31%	2.31%	2.29%

6.5.5 Financimi i programit kapital

Financimi i kostove investimeve për grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e tyre në parim do të duhej të mbulohej nga NPK Higjiena, megjithatë duke pasur për bazë nivelin a lartë të investimeve si dhe nivelin e kufizuar të hyrave të arkëtuara kjo kosto nuk mundet të mbulohej për periudhën 2018-2019 dhe deficitin do të duhej të mbulohej nga komuna. Sipas projekcionit të kostove dhe të hyrave në vitin 2019 NPK Higjiena duhet të participojë me 26,966 € respektivisht 8.9%. Komuna duhet të mbulojë pjesën e mbetur për vitet 2018 dhe 2019 me 412,350 € dhe 276,834 € respektivisht me 100% dhe 91.1%.

Sa i përket kostove investive të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave duhet të mbulohen në tërësi nga Komuna ose nga investitori privat nëse Komuna përcaktohet për transferimin e këtyre të shërbimeve tek sektori privat.

Nëse i refrohem kostove totale investive për MM financimi i tyre nga NPK Higjiena sillet nga 8.9% deri 100 % ndërsa pjesëmarrja e Komunës sillet nga 91.1 % deri 100 %.


Ky skenar i financimit bazohet në projeksionet e kostove të përlogarituar të shërbimit si dhe të hyrat e arkëtuara. Të gjitha këto janë të varura nga faktorët si zgjerimi i shërbimit, shkalla e arkëtimit dhe kostot reale. Nëse të hyrat dhe kostot reale do të ndryshojnë nga të hyrat dhe kostot e projektuara kjo do të reflektoj në aftësinë e kompanisë të alokoj mjete për buxhetin kapital si dhe pjesëmarrjes së komunës në balancimin e buxhetit kapital.

Për këtë arsye komuna përmes mekanizmave të veta duhet të monitoroj performancën financiare të kompanisë dhe varësisht nga kjo performancë të përshtatë buxhetin kapital për menaxhimin e mbeturinave të financuar nga ana e sajë.


Tabela Nr. 50: Financimi i kostove kapitale

Financimi i kostove kapitale	2018	2019	2020	2021	2022
Total Investime Kapitale	412,350	303,800	289,080	18,600	18,600
Total investimet për grumbullim dhe pastrim	412,350	303,800	18,600	18,600	18,600
Financuar nga NPK Higjiena (EUR)	0.0	26,966	18,600	18,600	18,600
<i>nga NPK Higjiena %</i>	<i>0.0%</i>	<i>8.9%</i>	<i>100.0%</i>	<i>100.0%</i>	<i>100.0%</i>
Financuar nga Komuna (EUR)	412,350	276,834	0.0	0.0	0.0
<i>Nga Komuna %</i>	<i>100.0%</i>	<i>91.1%</i>	<i>0.0%</i>	<i>0.0%</i>	<i>0.0%</i>
Total investimet për riciklim dhe ndarje	0.0	0.0	270,480	0.0	0.0
Financuar nga NPK Higjiena (EUR)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<i>nga NPK Higjiena %</i>	<i>0.0%</i>	<i>0.0%</i>	<i>0.0%</i>	<i>0.0%</i>	<i>0.0%</i>
Financuar nga Komuna (EUR)	0.0	0	270,480	0	0
<i>Nga Komuna %</i>	<i>100%</i>	<i>100%</i>	<i>100%</i>	<i>100%</i>	<i>100%</i>
Financimi i kostove kapitale	412,350	303,800	289,080	18,600	18,600
Total Investime Kapitale	412,350	303,800	18,600	18,600	18,600
Total investimet për grumbullim dhe pastrim	0	26,966	78,574	18,600	18,600
Financuar nga NPK Higjiena (EUR)	0.0%	8.9%	100.0%	100.0%	100.0%
<i>Komuna %</i>	<i>83.8%</i>	<i>72.1%</i>	<i>28.9%</i>	<i>79.0%</i>	<i>79.0%</i>

Grafiku Nr. 4: Financimi i programit kapital



Grafiku Nr. 5: Pjesëmarrja e financimit në investime kapitale



7 Plani i veprimit

Plani i detajuar i veprimit është dhënë si në tabelën Nr. 51 në vijim:

Qëllimi	Objekti	Veprimet	Përgjegjësi	Afati kohor	Implikimet buxhetore	Indikatori
Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit të mbeturinave	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë territorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.	O2.V1: Rishikimi i strukture organizative të kompanisë Higjiena	DSHP – KK Deçan, Higjiena	2018	-	Raporti i strukture organizative
		O2.V2: Trajnimi i stafit të operativës kompanisë Higjiena	DSHP – KK Deçan, Higjiena	2018	-	-
		O2.V3: Krijimi i bazës së të dhënave për operativën kompanisë Higjiena	DSHP – KK Deçan, Higjiena	2018	-	Data baza
		O2. V4. Takim me qytetarë në fshatrat që do të hyjnë në shërbim në vitin 2018. Përdorimi i mjeteve për informim (TV lokale, radio, media të shkruara)	DSHP – KK Deçan, Higjiena	Qershor 2018	1,000€	Një takim për fshat është organizuar
		O2. V5: Prokurimi i kamioneve kompaktues (shih investimet kapitale)	DSHP – KK Deçan, Higjiena	2018, 2019	-	
	O3: Optimizimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave.	O3.V1: Prokurimi i kontenjerave 120 lit dhe 1.1m ³ (shih investimet kapitale)	DSHP – KK Deçan	2018, 2019, 2020, 2021, 2022	-	Kontrata e nënshkruar
		O3.V2: Shpërndarja e kontenjerave në cdo amvisëri	DSHP – KK Deçan, Higjiena	2018, 2019, 2020, 2021, 2022	500€ cdo vit	Cdo familje e pajisur me kontenjer
Inicimi i procesit për ndarje të mbeturinave në burim duke synuar që të zvogëlohet sasia e mbeturinave që	O4: Ndarja e mbeturinave në burim në shkollat publike dhe institucionet publike komunën e Deçanit,	O4.V1: Hulumtimi në terren për të identifikuar në saktësi numrin e nevojshëm të kontenjerëve për cdo institucion	DSHP – KK Deçan	2018	5,000 €	Raporti me numër të nxënësve, punonjësve, numrin e nevojshëm të kontenjerave dhe implikimet buxhetore.

përfundojnë në deponi.	deri në fund të vitit 2021.	O4.V2: Prokurimi i kontenjereve të nevojshëm për fillim të ndarjes së mbeturinave për fazën e parë 2018	DSHP – KK Deçan	2018	-	-
		O4.V3: Organizimi i takimeve dhe ligjeratave me nxënësit e shkollave, mësimdhënësit, dhe punonjësit e institucioneve publike për të spjeguar procesin e ndarjes së mbeturinave dhe përfitimet nga ky proces për fazën e parë 2018	DSHP – KK Deçan	2018	-	-
		O4.V4: Zbatimi i fazës së parë të ndarjes së mbeturinave 2020	DSHP – KK Deçan	2020	-	Shkollat dhe objektet publike në qytet janë duke ndarë mbeturinat
		O4.V5: Prokurimi i kontenjereve të nevojshëm për fillim të ndarjes së mbeturinave për fazën e parë 2019	DSHP – KK Deçan	2020	-	-
		O4.V6: Zbatimi i fazës së dytë të ndarjes së mbeturinave 2020	DSHP – KK Deçan	2021	-	Shkollat dhe objektet publike në fshatra janë duke ndarë mbeturinat
	O5: Inicimi i ndarjes së mbeturinave në burim në amvisëri, në dy fraksione (të reciklueshme dhe të pa reciklueshme) deri në fund të viti 2021.	O5.V1: Organizimi i takimit me qytetarë për të spjeguar procesin e ndarjes së mbeturinave dhe përfitimet nga ky proces.	DSHP – KK Deçan	2021	-	Minimum një takim me qytetarë.
		O5.V2: Inicimi i ndarjes së mbeturinave në x familje në qendër të qytetit	DSHP – KK Deçan	2021	-	Amvisëritë janë duke ndarë mbeturina.
	O6: Ndarja e mbeturinave në hapësira publike nëpërmes ishujve ekologjik, në 3 lokacione deri në fund të viti 2021.	O6.V1: Identifikimi i lokacioneve për vendosjen e ishujve të gjelbër	Drejtoria e Urbanizmit DSHP – KK Deçan	2021	-	3 lokacione në qytet për ishujt të gjelbër janë identifikuar
		O6.V2: Prokurimi i kontenjereve të plastikës 1.1 m³ dhe 240 lit për t'i vendosur në ishujt e gjelbër	DSHP – KK Deçan	2021	-	-

	O7: Inicimi i procesit të menaxhimit sistematik të mbeturinave të vëllimshme.	Përcaktimi i orarit të grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme	DSHP – KK Deçan	2018	-	Qytetarët janë të informuar se në cilën kohë kompania do të mbledhë mbeturinat e vëllimshme.
	O8: Krijimi i sistemit lokal të kompostimit, përmes sigurimit të komposterëve individual për 1,000 familje deri në fund të viti 2021.	O8.V1: Kampanja informuese për fillim të procesit të kompostimit	DSHP – KK Deçan	2020	-	Broshura dhe pllakate të shypura; informata në media të shkruara dhe elektronike për fillim të procesit për kompostim
		Prokurimi i enëve kompostuese	DSHP – KK Deçan	2020	-	-
		Shpërndarja e enëve kompostuese	DSHP – KK Deçan	2020	-	-
Grumbullimi, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglim të sasisë që përfundon në deponi.	O9: Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave shtazore deri në vitin 2018.	O9.V1: Kampanja informuese për mishtorët, therrëtorët, dhe fermat që të pajisen me kontejnera të veçantë për mbeturina shtazore	DSHP – KK Deçan	2018	-	Vizita të inspektorëve mjedisor në cdo mishtore, therrëtores, dhe fermë.
		O10.V2: Modeli i operimit për grumbullim të veçantë të mbeturinave shtazore nga mishtoret, therrëtores, dhe fermat.	DSHP – KK Deçan	2018	-	Kompania ka filluar të grumbullojë në mënyrë të veçantë mbeturinat shtazore.
	O11: Menaxhim i qendrueshëm i mbeturinave ndërtimore.	O11.V1: Prokurimi i pozicioneve për ndërtim të qendrës për mbeturina ndërtimore	DSHP – KK Deçan	2019	-	Tenderi është shpallur
		O10.V2: Funkcionalizimi i qendrës grumbulluese për mbeturinat	DSHP – KK Deçan	2020	-	Kontrata për menaxhim të qendrës grumbulluese me kompani private është nënshkruar
	O12: Reformat administrative	O12. V1: Themelimi i njesisë për menaxhim të mbeturinave	DSHP – KK Deçan	2018	-	

		O12. V2: Miratimi i rregullues per menaxhim të mbeturinave	DSHP – KK Deçan	2018	-	
	O13: Përcaktimi i tarifës për grumbullim, transportim dhe deponim te mbeturinave	O13. V1: tarifa është përckatuar	DSHP – KK Deçan	2018	-	Rregullorja
Vetëdijësimi	O14: Krijimi i kampanjës për vetëdijësim dhe informim rreth efekteve pozitive dhe negative të mbeturinave, rreth orarit dhe rregullave të grumbullimit dhe hedhjes së mbeturinave.	O11.V1: Kontraktimi i kompanisë për dizajnim të kampanjës	DSHP – KK Deçan	2018	3,000 €	Kompania për dizejnim të kampanjës është kontraktuar
		O11.V2: Organizimi i aktiviteteve nga kampanja e informimit dhe edukimit	DSHP – KK Deçan	2018	-	-